

1 E hënë, 19 qershor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hynë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 09.00

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretarja e  
7 Gjykatës, paraqisni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo është çështja KSC-  
9 BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit,  
10 Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

12 Sot do të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit 03540. Vë re  
13 që të akuzuarit janë të pranishëm në sallën e gjyqit, ndërsa  
14 z. Krasniqi vazhdon të na ndjekë me videolidhje.

15 Përpara se të ftoj dëshmitarin në sallën e gjyqit ka disa  
16 çështje organizative që dëshiroj të trajtoj.

17 Pikë së pari, edhe një herë, Trupi Gjykses është  
18 shqetësuar me ritmin si po shkojnë dëshmitë, duke pasur  
19 synimin që Prokurori synon ta përfundojë paraqitjen e provave  
20 në prill të 2025, unë u detyrova të bëja ca llogaritje edhe  
21 kemi bërë rreth 120 orë deri në fund të kësaj jave. Domethënë,  
22 rreth 10 dëshmitarë ose 12 orë për dëshmitar. Bëjini vetë  
23 llogaritë sa i takon planifikimit dhe të kuptoni se cili është  
24 rezultati. Por me këtë ritëm s'kemi për ta realizuar afatin.

25 Në interes të kursimit të kohës nuk është e domosdoshme

1 t'i pyesni dëshmitarët për çështje të cilat nuk janë nevojë të  
2 shqyrtohen. Prokuroria duhet ta reduktojë kohën që nevojitet  
3 për pyetjet nga ana e vet. Po ashtu, Mbrojtja ka shpenzuar një  
4 kohë të madhe për çështje anësore apo çështje që nuk janë  
5 objekt shqyrtimi mes palëve.

6 Rregulla 154 është apostafat për të reduktuar kohën që  
7 nevojitet për të bërë pyetjet nga ana e Prokurorisë dhe  
8 ndonjëherë na janë dashur orë të tëra për të pyetur  
9 dëshmitarët e rregullës 154. Duhet ta ndryshojmë ne, mund ta  
10 ndryshojmë ne si Trup Gjykues, por e sugjerojmë që ta bëjë  
11 vetë Prokuroria.

12 Ne i kemi lexuar deklaratat, ne e dimë çfarë kanë thënë  
13 dhe t'i pyesni prapë dëshmitarët për gjëra që ne i kemi lexuar  
14 në deklaratat e tyre nuk i bën kujt nder. Aftësia që të  
15 respektojmë afatet, mbështetet, pra, të gjithë ne duhet të  
16 kujdesemi që të respektojmë afatet për hir të të akuzuarve.  
17 Pres nga të gjitha palët që të bëjnë përpjekje për ta bërë  
18 këtë.

19 Gjithashtu, duke pasur parasysh bllokun aktual të  
20 dëshmitarëve, Trupi Gjykues vëren se koha e parashikuar për  
21 kundërpyetjet nga Mbrojtjet është e shumë e ekzagjeruar.  
22 Sigurisht kjo është një vështirësi për Prokurorinë, jo se po  
23 justifikoj Prokurorinë, por e ka shumë të vështirë Prokuroria  
24 që të bëjë planifikimin, duke pasur parasysh kohën që ne mund  
25 të përdorimin në sallën e gjyqit.

1 Prandaj, i lutemi Mbrojtjes të rishikojë kohën që  
2 nevojitet për të marrë në pyetje dëshmitarët dhe të bëjë një  
3 përllogaritje më të saktë dhe presim këto përllogaritje të na  
4 e thonë nesër. Dhe shpresojmë që të reduktohet koha e  
5 kundërpyetjeve; ne të vihemi në dijeni si Trup Gjykues edhe si  
6 Prokurori pa asnjë vonesë. Këtu i referohem dëshmitarit 03540,  
7 3811, 3437 [sipas përkthimit], 4940 [sipas përkthimit], më  
8 falni, 20, 4746.

9 Ky është urdhri i parë gojor i Trupit Gjykues.

10 Tani, sa i takon kërkesës së përbashkët të Thaçit,  
11 Veselit dhe Krasniqit për shtyrjen e afatit për të kërkuar  
12 leje për të apeluar dy vendime. Ky aplikim, është aplikimi  
13 konkretisht i protokolluar F01612 dhe është protokolluar të  
14 premtën pasdite dhe është shpërndarë pas orës 17.00. Në kuadër  
15 të përsheptimit të kësaj kërkesë do ju lutesha që sa më  
16 shpejt të na thoni nëse e kundërshtoni kërkesën, shtyrjen dhe  
17 i drejtohem Prokurorisë fillimisht.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ne mendojmë se shtyrja është e  
19 nevojshme dhe e përshtatshme, por ne thjesht i mëshojmë asaj  
20 që sapo thatë ju, sa i takon protokollimit 1596, afati është  
21 sot dhe është protokolluar vetëm të premtën pasdite, kështu që  
22 koha është shumë e shkurtër.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
24 çaktivizuar]

25 Z. LAWS: [Përkthim] Ne nuk kemi asgjë për të shtuar.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
2 çaktivizuar]

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ne nuk e kundërshtojmë kërkesën, i  
4 nderuar Gjykatës, qartësisht kjo.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, ne  
6 do të tërhiqemi për një çast për të vendosur lidhur me këtë  
7 kërkesë.

8 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Miratohet  
10 shtyrja deri më datën 26 të këtij muaji, në orën 4.00 të  
11 pasdites.

12 Trupi Gjykses mendon se ka arsye të vlefshme duke pasur  
13 parasysh ndërlikimin e vendimit dhe faktin që nuk cenon asnjë  
14 prej palëve. Nuk do t'i cenonte, pra, Prokurorisë asnjë  
15 aspekt. Kështu që, miratohet leja për ta apeluar vendimin. Me  
16 këtë mbyll edhe urdhrin e dytë me gojë të Trupit Gjykses.

17 Urdhri i tretë me gojë, është një çështje sa i takon  
18 masave mbrojtëse të cilat do t'i shpjegoj në fakt në seancë  
19 private. Për këtë do i lutesha Sekretares të na kalonte në  
20 seancë private.

21 [Seancë private]

22 [Seancë private teksti i fshirë]

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur]

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,

8 jemi gati të fillojmë me dëshminë tuaj.

9 Sikurse e dini, fillimisht do t'ju bëjë pyetje Prokuroria  
10 dhe pastaj Mbrojtësi i Viktimave. Kur të mbarojnë këto dy palë  
11 ka të drejtë Mbrojtja që t'ju drejtojë pyetje. Edhe Trupi  
12 Gjykues mund t'ju bëjë disa pyetje.

13 Prokuroria parashikon dy orë për pyetjet e veta.  
14 Mbrojtësi i Viktimave mendon se i nevojitet çerek ore për të  
15 bërë pyetjet. Aktualisht Mbrojtja parashikon 8 orë për t'ju  
16 bërë pyetje. Sa i takon këtyre parashikimeve do u lutesha  
17 palëve të jenë të kujdesshëm në përdorimin e kohës. Trupi  
18 Gjykues mund të kërkojë, mund të lejojë Prokurorinë të bëjë  
19 pyetje shtesë nëse përmbush kushtet.

20 Dëshmitar, përpiquni të përgjigjeni qartë, me fjali të  
21 shkurtër. Nëse nuk e kuptoni pyetjen lirisht kërkonit të  
22 përsëritet. Palët mund ta përsërisin pyetjen në bazë të  
23 kërkesës suaj. Nëse nuk e kuptoni mjaft t'jua thoni që nuk e  
24 kuptoni dhe do ta sqarojmë për ju. Po ashtu na tregoni ku e  
25 keni bazuar njohurinë e fakteve, të rrethanave lidhur me

1 përgjigjet që do të jepni apo informacionin që do të jepni.

2 Nëse Prokuroria ju kërkon të shihni disa nga korrigjimet  
3 që keni bërë ndaj deklaratave tuaja ju kujtojmë të konfirmoni  
4 për procesverbal që deklarata me shkrim është e korrigjuar dhe  
5 reflekton saktësisht deklaratën tuaj.

6 Flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara se  
7 të përgjigjeni. Flisni ngadalë që edhe përkthyesit të kenë  
8 mundësi t'ju ndjekin.

9 Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në këtë sallë gjyqi nuk  
10 ju lejohet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj  
11 jashtë mureve të sallës së gjyqit.

12 Nëse ju pyet ndokush pyetje jashtë sallës së gjyqit  
13 lidhur me dëshminë tuaj na vini në dijeni.

14 Nëse keni nevojë për pushime në ndonjë çast, na thoni do  
15 të përpiqemi t'jua plotësojmë këtë kërkesë.

16 Do të fillojmë me pyetjet nga Prokuroria që janë në anën  
17 që po tregojmë me dorë. Kështu që mund t'ju jepni përgjigje.

18 Prokuror, mund të filloni.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A mund të kalojmë shkurtimisht,  
20 sa për të marrë të dhënat personale, në seancë private?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në  
22 seancë private, ju lutem.

23 [Seancë private]

24 [Seancë private teksti i fshirë]

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
11 çaktivizuar]

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, në të kaluarën keni dhënë shumë dëshmi për  
14 autoritete të ndryshme. Edhe unë do kërkoj në ekran që të  
15 shfaqen të gjitha deklaratat e mëparshme që Prokuroria synon  
16 t'i paraqesë si prova. Ju lutem, shihni në ekran çfarë do ju  
17 shfaqen përpara.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, fillimisht  
19 do kërkoj që të shfaqen deklaratat e ndryshme dhe do vazhdoj  
20 me modalitetet, formalitetet e rregullës 154.

21 A mund t'ju kërkoj, të lutem të shfaqni në ekran  
22 materialin me nr. SPOE00123186 deri në 00123218 RED; kjo është  
23 anglishtja. Edhe ngjitur me këtë është serbishtja që ka numrin  
24 00123186 deri në 00123218RED, edhe është serbishtja, RED-S,  
25 është versioni serbisht. Atëherë vendosim shqipen, meqë nuk

1 qenka.

2 PY. Dëshmitar, deklaratata e parë që Prokuroria synon të  
3 paraqesë si provë është transkripti që keni dhënë ju para  
4 gjykatësit hetues në Gjykatën e Rrethit Prishtinë në çështjen  
5 kundër Latif Gashit dhe të tjerë edhe kjo është mbajtur më 23  
6 mars, ky gjyq është mbajtur më 23 mars 2003. Konkretisht  
7 SPOE00123186, edhe 00123218 RED, kjo është anglishtja. Ndërsa  
8 shqipja është me numër 00123222 deri në 00123251 RED, kjo  
9 është shqipja.

10 Këto i kemi dhe serbisht, i keni në serbisht te dosja që  
11 keni përpara, te numri 1. Shihni faqen e parë që keni përpara,  
12 në ekran. A e njihni këtë deklaratë që shihni këtu?

13 PË. Kam një pyetje: kam dy deklaratata përpara.

14 PY. Në të djathtë është një deklaratë që ka një nënshkrim në  
15 fund.

16 Z. STRONG: [Përkthim] Më falni, mbase do ishte më mirë që  
17 të shfaqnit serbishten në ekran apo të konfirmojnë nëse ta  
18 pyesim Dëshmitarin a flet shqip, se me sa kuptojmë --

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të drejtë keni. Kemi kërkuar që  
20 të fshihej, të futej në listën e materialeve për prezantim.  
21 Fatkeqësisht më bënë me dije që nuk është ende e futur në  
22 listën e materialeve.

23 Z. STRONG: [Përkthim] Atëherë mbase më mirë t'i thonit të  
24 shikojë dosjen, sepse me sa po kuptoj, ekrani nuk ka për t'i  
25 hyrë në punë.



- 1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.
- 2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]
- 3 PY. Dëshmitar, shikoni këtë deklaratën.
- 4 PË. Është nënshkrimi im.
- 5 PY. Në fund të faqes, ë, kështu?
- 6 PË. Unë e kam nënshkruar. Po, është deklarata ime.
- 7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kalojmë në faqen 27 të
- 8 anglishtes, SPOE00123212.
- 9 PY. I njihni nënshkrimet që janë në këtë faqe, Dëshmitar?
- 10 PË. Po, e njoh.
- 11 PY. E keni dhënë ju këtë deklaratë?
- 12 PË. Po.
- 13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit. Mund ta hiqni nga
- 14 ekрани. Ju lutemi tani vendoseni në ekran deklaratën tjetër që
- 15 është SPO00119959 deri në 00119975 RED, kjo është anglishtja.
- 16 Dhe në ekran, në të majtë, vendosni serbishten që shpresoj të
- 17 jetë përfshirë në listën e materialeve me të njëjtin numër,
- 18 por mbaron me ST RED. Në qoftë se nuk është serbishtja, t'ia
- 19 japim kohë Dëshmitarit të shikojë dosjen me mekanizëm që ka
- 20 përpara. Paketa 2, me numrin 2.
- 21 PY. Atëherë, Dëshmitar, ky është transkripti që keni përpara
- 22 jush edhe në nënndarjen 2 në dosjen që keni përpara. Kjo është
- 23 deklarata që keni dhënë përpara Gjykatës së Komunës së
- 24 Prishtinës. Atëherë, ky është procesverbali i shqyrtimit
- 25 gjyqësor përpara Gjykatës Rajonale të Prishtinës dhe mban

1 datën qershor 2003.

2 Pyetja që kam për ju është kjo: A e keni dhënë këtë  
3 deklaratë apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Faleminderit.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund ta heqim atëherë këtë  
7 deklaratë nga ekрани. Ju lutem, a mund të paraqitet një tjetër  
8 deklaratë me numër identifikimi SPOE00087525 deri në 00087560  
9 RED. Është versioni në anglishte.

10 PY. Dëshmitar, në nënndarjen 3 duhet të keni versionin në  
11 serbisht të deklaratës që unë përmenda më lart.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në transkriptin në anglishte  
13 faqja përkatëse është SPOE00087535 deri në SPOE00087554. Në  
14 qoftë se Sekretarja mund ta transmetojë këtë deklaratë.

15 PY. Ju lutemi, shikoni pak dokumentin që keni përpara jush;  
16 shikoni gjithashtu edhe emrin dhe mbiemrin tuaj.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kemi dhe versionin në shqip dhe  
18 do ta përmend për procesverbal. Është dokumenti SPOE00087525  
19 deri në SPOE00087560-AT RED. Ndërkohë që faqet përkatëse janë  
20 SPOE00087535 deri në SPOE00087554-AT RED.

21 PY. E patë?

22 PË. Po.

23 PY. Faleminderit.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund t'i heqim këto deklarata  
25 nga ekрани tani.

1 A mund të transmetohet tani dokumenti 070629-TR-ET, Pjesa  
2 2 e Rishikuar. Le të shikojmë Pjesën 1 të Rishikuar, së pari.  
3 Ndërkohë që versioni serbisht është po ashtu me të njëjtin  
4 numër, por nuk e ka vizën ET. Po ashtu bëhet fjalë për Pjesën  
5 e 1-rë të këtij dokumenti.

6 PY. Dëshmitar, ju lutem, shikoni nëndarjen numër 4 te dosja  
7 që keni përpara.

8 Dëshmitar, kjo është deklarata që ne synojmë të paraqesim  
9 për t'u pranuar në provë materiale dhe ky është transkripti i  
10 intervistës me ZPS-në që është mbajtur më datë 4 dhjetor 2019.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Për procesverbal është  
12 dokumenti 070629-TR, Pjesa 1 dhe 2 të Rishikuara -ET RED edhe  
13 në versionin në serbisht është i njëjti numër dokumenti, po  
14 gjithashtu edhe Pjesa 1, Pjesa 2 RED. Edhe në versionin në  
15 shqip dokumenti mban të njëjtin numër, është Pjesa 1 dhe Pjesa  
16 2, është -TR-AT RED. Pra, ky është versionin në shqipe.

17 PY. Ju lutem, hidhini një sy faqes së parë. A mund të na  
18 thoni në qoftë se e keni dhënë këtë deklaratë për ZPS-në,  
19 Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Dëshmitar, gjatë takimit kohët e fundit për përgatitjen e  
22 dëshmitarit, që kemi organizuar të premtën, a ju dha mundësia  
23 që të rishikonit të gjitha deklaratat e mëparshme të dhëna  
24 lidhur me këtë çështje?

25 PË. Po.

1 PY. Në atë seancë përgatitore, ju dhatë disa qartësime lidhur  
2 me deklaratat që keni dhënë më herët, kështu?

3 PË. Po.

4 PY. A janë pasqyruar këto sqarime në shënimin që ju lexua në  
5 fund të seancës përgatitore që organizuat me ZPS-në të premten  
6 e javës së shkuar?

7 PË. Po.

8 PY. A mund të konfirmoni se ajo që ju lexua në fund të ditës  
9 reflektonte plotësisht dhe qartësisht të gjitha sqarimet që ju  
10 bëtë?

11 PË. Po.

12 PY. Duke marrë parasysh sqarimet që kemi pasqyruar në  
13 shënimet në fund, deklaratat e shkruara të tuajat, a  
14 pasqyrojnë plotësisht dëshminë tuaj dhe a do të jepni të  
15 njëjtat përgjigje në qoftë se do të pyeteshit për të njëjtat  
16 pyetje edhe këtu përpara Trupit Gjykses?

17 PË. Po.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ZPS-ja  
19 kërkon që të pranohen në prova materiale deklaratat e  
20 mëparshme të dëshmitarit, në pajtim me rregullin 154 sikurse  
21 janë prezantuar për procesverbal dhe siç janë dhënë në  
22 dokumentet e parashtruara nga Prokuroria.

23 Kërkoj që të pranohen në prova materiale dhe dokumentet e  
24 mëposhtme. Së pari, raportin mjekësor të Dëshmitarit W03540 në  
25 periudhën nga 13 shkurti [sipas përkthimit] 1998 deri në 4

1 nëntor 1999 dhe numrat ERN të tyre janë si më poshtë. Nuk  
2 është e nevojshme që t'i paraqesim në ekran. Për versionin në  
3 anglisht është dokumentin SPOE00209223 deri në 00209244 RED.  
4 Për versionin në serbisht është dokumenti me numë identifikimi  
5 SPOE00202, ndjesë, edhe një herë. Atëherë SPOE00209245 deri në  
6 00209265 RED. Dhe për versionin në shqipe janë dokumentet  
7 SPOE00209199 deri në 0020922-RED.

8 Një tjetër provë materiale e lidhur ka të bëjë me  
9 versionin e redaktuar të nënzonës operative të Llapit,  
10 vendimit të nënzonës operative të Llapit për lirim e  
11 dëshmitarit 03540 datë 26 shtator 1998. Për versionin anglisht  
12 dokumenti mban numrin e identifikimit U001-0504-U001-0504-ET  
13 RED. Për versionin në shqipe dokumenti mban të njëjtin numër  
14 identifikime por nuk ka -ET në fund.

15 Të nderuar Gjykatës, dëshiroj gjithashtu që të paraqes  
16 për regjistrim si provë materiale dokumentin për përgatitjen e  
17 dëshmitarit të përgatitur të premtën e javës që shkoi. Pra,  
18 është një shënim që mban datën 16 qershor 2003 dhe është  
19 shënim që përmban qartësime të tjera të lidhur me Dëshmitarin,  
20 me atë çfarë ka thënë dëshmitari në deklaratat e mëparshme dhe  
21 dokumente të tjera shoqëruese. Është dokumenti ERN 113598-  
22 113603. Nuk është akoma në sistemin juridik Legal Workflow,  
23 por besoj që duhet të jetë aty për çështje minutash, të  
24 nderuar Gjykatës.

25 Të nderuar Gjykatës, kjo përfundon procedurën që lidhet

1 me rregullin 154.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
3 kundërshtim?

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

5 Z. STRONG: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim; nuk kemi  
6 kundërshtim edhe për shtimin e versionit në serbisht në listën  
7 e dokumenteve të parashtruara nga ZPS-ja, sepse mendoj që do  
8 të ishte me vlerë për të gjithë ne. Nuk është e thënë që të  
9 bëhet, por në një moment të përshtatshëm do ishte mirë që të  
10 jepen edhe përkthimet në serbisht.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, jam  
12 dakord. Besoj që do ishte që të ngarkoheshin edhe dokumentet e  
13 përkthimet në serbisht.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në rregull.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta  
16 bëni deri nesër?

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do ta bëjmë sot. Të gjithë  
18 dokumentet janë gati. I janë dhënë sigurisht dëshmitarit  
19 [sipas përkthimit], por ndoshta ka pasur ndonjë problem teknik  
20 që nuk janë ngarkuar në sistem.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
22 Ju lutem, sigurohuni që të ngarkohen këto dokumente.

23 Ndonjë kundërshtim tjetër?

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo.

25 Kolegët e tjerë, jo.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, të  
2 gjithë dokumentet të cilat u parashtruan nga Prokuroria janë  
3 mbajtur shënim dhe pranohet në prova materiale.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
5 Gjykatës.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast, ju  
7 lutem, Z. Prokuror.

8 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës  
9 këshillohen]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
11 caktojini numrat e provave materiale këtyre dokumenteve. Nuk e  
12 di në qoftë se doni ta bëni tani apo më vonë. Pra, Sekretarja  
13 do t'i japë numrin e provave materiale dokumenteve që juve  
14 sapo përmendët.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dëshmitar --

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, thashë që  
17 Sekretarja do të japë numrin e provave materiale.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të  
19 nderuar Gjykatës.

20 Deklarata e parë që mban numrin e identifikimit  
21 SPOE00123186, numri i provës materiale do të jetë P190.

22 Deklarata e dytë me numër identifikimi SPOE00119959 deri  
23 në 00119975 RED do të marrë provën materiale, numrin e provës  
24 materiale P191.

25 Për deklaratën e 3-të që aktualisht ka numrin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03540 (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Michalczuk

Faqe 24

1 SPOE00087525 deri në 0087560 - RED, do të marrë numrin e  
2 provës materiale P192.

3 Deklarata e 4-t, aktualisht me numër identifikimi 070629-  
4 TR, Pjesa 1 e rishikuar RED do të marrë numrin e provës  
5 materiale 193.1 dhe Pjesa e 2-të do të marrë provën materiale  
6 193.2

7 Për provat e lidhura SPOE00209223 deri në 00209244 RED  
8 dhe për përkthimet e veta përkatëse, pra, këto dokumente do të  
9 marrin numrin e provës materiale 9194.

10 Dokumenti U0010504 deri në U0010504-ET RED dhe versioni  
11 në anglisht [sipas përkthimit] do të marrë numrin e provës  
12 materiale P195.

13 Dhe së fundi, dokumenti përgatitur me numër ERN 113598  
14 deri 113603, do t'i caktohet prova materiale P196.  
15 Faleminderit të nderuar Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
17 vazhdoni z. Michalczuk.

18 Faleminderit znj. Sekretare.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, kam disa pyetje për ju: Në kohën kur jeni  
21 arrestuar me datë 2 shtator [sipas përkthimit] 1998 në pyllin  
22 e Bradashit, a mund të na thoni çfarë profesioni kishit ju në  
23 atë kohë?

24 PË. Isha roje, rojtar pylli.

25 PY. Si rojtar pylli a keni qenë ju pjesë e policisë ose



1 ushtrisë serbe?

2 PË. Jo.

3 PY. Gjatë kohës kur ju arrestuan, a rezistuat ndaj këtij  
4 akti?

5 PË. Jo.

6 PY. A e nxorët pistoletën në ndonjë kohë gjatë arrestimit që  
7 ju bë?

8 PË. Jo. Ma morën ata.

9 PY. A mund t'i tregoni Gjykatës se si reaguat kur patë  
10 ushtarët e UÇK-së në atë moment, pra, kur ju arrestuan juve  
11 atje në pyll?

12 PË. Ndërkohë që po kontrolloja pyllin në pikën e quajtur "Uji  
13 i Mirë", e pashë që po priteshin disa pemë. Kështu që shkova  
14 për të parë se çfarë po bëhej atje e sepse bëhej fjalë për një  
15 pyll shtetëror. Uji i Mirë është një përrua i madh dhe është  
16 kur shkon për në Keqekoll.

17 Kur shkova atje, kur mbërrita atje pashë që katër dolën  
18 nga asgjëja dhe që kishin armë automatike. Unë i ngrita duart.  
19 Ata m'u afruan, më mbyllën sytë, më lidhën duart pas shpine,  
20 ndërkohë që dy prej tyre vazhdonin që të prisnin dru atje.

21 PY. Çfarë ndodhi me armën që kishit?

22 PË. Ata e konfiskuan pistoletën time; ata të katërt ma morën  
23 pistoletën. Thjesht më thanë, ngri duart. Njëri prej tyre m'u  
24 afrua dhe më mori pistoletën.

25 PY. Faleminderit.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund të  
2 paraqisni tani në ekran një dokument me numër identifikimi  
3 U0010504 deri në U0010504. Nuk e regjistрова numrin e provës  
4 materiale që thatë. Ju kërkoj ndjesë.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është P195.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dhe gjithashtu ju lutem, nëse  
7 është e mundur, shfaqni dhe versionin në shqip të të njëjtit  
8 dokumenti.

9 Të nderuar Gjykatës, kur shohim këtë dokument në shqip ne  
10 kemi një dokument që ka versionin më të mirë. D.m.th në qoftë  
11 se është e mundur do kërkoja që të shfaqet dokumenti që ka një  
12 version më korrekt dhe do të ishte më mirë mbase që t'i  
13 tregohej versioni më i mirë për palët në gjykatë.

14 Versioni më i mirë i të njëjtit dokumenti mban numrin e  
15 identifikimit SPOE00123219 deri në 00123221. Ju lutem,  
16 paraqisni faqen e parë. Ta them edhe një herë? Atëherë duhet  
17 të jetë dokumenti me numër identifikimi SPOE00123219. Fillon  
18 me këtë numër. Në qoftë se nuk e gjeni dot mund të vazhdojmë  
19 me këtë version që është shfaqur tashmë në ekran.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Nuk është në listën e  
21 dokumenteve që keni paraqitur.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

23 PY. Dëshmitar, ju lutem shikoni pak dokumentin që keni në të  
24 majtë të ekranit. Çfarë është ky dokument?

25 PË. Ky është një dokument që më dhanë kur më liruan. Pra, më

1 dhanë këtë dokument i cili thotë se kur jam arrestuar dhe kur  
2 jam liruar. Megjithatë, ky dokument nuk është pranuar në  
3 gjykatë. Më thanë që ky ishte një dokument i falsifikuar. Pra,  
4 që unë e kisha falsifikuar këtë dokument.

5 Ajo çfarë thuhet në këtë dokument është që arma zyrtare  
6 m'u mor, pra, pistoleta që kisha me vete. Pra, ma morën dhe që  
7 unë isha përpjekur që të qëlloja në drejtim të anëtarëve të  
8 UÇK-së. Megjithëse, nuk mund ta kisha bërë dot një gjë të  
9 tillë. Megjithatë, m'u desh që të nënshkruaj këtë dokument në  
10 mënyrë të tillë që të lirohesh. Ka pasur dhe një tjetër  
11 dokument Latif Gashi ma lexoi atë dokument, një dokument  
12 tjetër dhe më kërkoi që ta nënshkruaja atë. Dhe dokumenti  
13 thoshte që unë nuk do të shkelja më në Kosovë dhe gjëja e dytë  
14 për të cilën do të duhet të nënshkruaja ishte që nuk është se  
15 jam keqtrajtuar gjatë asaj kohe. Dhe gjëja e tretë për të  
16 cilin duhej që të nënshkruaja ishte që mua më ishte dhënë të  
17 gjitha gjërat që kisha pasur, përveç pistoletave.

18 PY. Në rregull, atëherë le të përqendrohemi te ky dokument  
19 një herë, për momentin. Kush jua dha ju këtë dokument?

20 PË. Mua m'u dha ky dokument nga Latif Gashi.

21 PY. A njihni ndonjë nënshkrim, a keni parë ndonjë nënshkrim  
22 që njihni në këtë dokument?

23 PË. Jo. Kur e mora këtë dokument, ky dokument ishte  
24 nënshkruar.

25 PY. Nuk po flas për dikë që e ka nënshkruar dokumentin. Po ju

1 pyes në qoftë se keni parë ndonjëherë prej nënshkrimeve në  
2 këtë dokument. Domethënë ka dy nënshkrime dokumenti: njëri  
3 është në të majtë; dhe tjetri është në të djathtë. A e keni  
4 parë ndonjëherë ndonjërin prej këtyre nënshkrimeve? A i njihni  
5 këto nënshkrime?

6 PË. Është një nënshkrim aty, [REDAKTUAR] dhe nuk e kam  
7 idenë fare se kush e ka nënshkruar atë.

8 PY. Është nënshkrimi juaj?

9 PË. Po.

10 PY. Më duhet të sqaroj diçka lidhur me këtë dokument. Në  
11 paragrafin e dytë e keni gjithashtu edhe si pjesë së dosjes që  
12 është dhënë, e keni përpara. Në paragrafin e dytë në këtë  
13 dokument thuhet që anëtarët e UÇK-së kur ju thanë që të  
14 ndalonit në kohën e arrestit, ju nuk e bëtë këtë gjë. Dhe që  
15 nxorët pistoletën dhe e drejtuat në drejtim të tyre. A ka  
16 ndodhur realisht kjo gjë?

17 PË. Jo. Nuk ishte as e mundur të bëhej një gjë e tillë. Sepse  
18 ata dolën nga asgjëja, thjesht u shfaqën përpara syve. Ishin  
19 rreth tre metra larg nga unë.

20 PY. Nëse nuk ka ndodhur kështu pse e keni nënshkruar këtë  
21 dokument, a mund t'i thoni Trupit Gjykues, pse e keni  
22 nënshkruar këtë dokument?

23 PË. Më duhej, e kisha të nevojshme që ta nënshkruaja në qoftë  
24 se doja të lirohesh. Ky është një dokument që mban datën 26  
25 shtator. Kjo është data kur më kanë liruar.

1 PY. A po thoni se në atë kohë ishit të frikuar se në qoftë se  
2 nuk do të nënshkruanit nuk do liroheshit?

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Më lejoni që të përfundoj me  
4 pyetjen, së pari.

5 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykses, më saktë, si je ndjerë  
6 kur të është dashur që të nënshkruaje këtë dokument?

7 PË. As nuk isha mjaftueshëm i vetëdijshëm dhe siç e thashë,  
8 në qoftë se kam nënshkruar që, pra, duhej që të nënshkruaja që  
9 nuk do të shkel më në Kosovë, që nuk jam keqtrajtuar, që nuk  
10 më ka ndodhur asgjë e keqe, do ta nënshkruaja se bëhej fjalë  
11 për jetën time. Sepse në qoftë se do ta nënshkruaja do të  
12 thoshte që do të lirohesha.

13 PY. Besonit që nuk kishit asnjë zgjidhje tjetër, por ju duhej  
14 me patjetër që ta nënshkruanit këtë dokument?

15 PË. Nuk kishte zgjidhje tjetër.

16 PY. Dëshmitar, tani duhet ta ndryshojmë paksa temën. Në  
17 dëshminë që keni dhënë, në çështjen gjyqësore kundër Latif  
18 Gashit dhe të tjerë, dëshmi e cila sapo u pranua në prova  
19 materiale, ju diskutoni për një person të ndaluar bashkë me  
20 juve që quhej Sali Berisha në Bajgorë, Sabit Berisha. A e dini  
21 arsyen se pse ishte ndaluar, pse është marrë në pyetje dhe pse  
22 është keqtrajtuar ky person?

23 PË. Sabit Berisha më tregoi se tri ditë pasi ishte arrestuar  
24 dhe në fakt atë e kishin rrahur po aq keq sa më kishin rrahur  
25 mua dhe kur u bë i ndërgjegjshëm, kur u rikëmb ai më tha që

1 ishte akuzuar se kishte bashkëpunuar me ca serbë dhe se ishin  
2 gjendur disa dokument të Beogradit në zotërim të tij dhe për  
3 këtë arsye ishte burgosur.

4 PY. A ju tregoi më konkretisht ai se për çfarë dokumentesh  
5 bëhej fjalë, çfarë dokumentesh i kishin gjetur?

6 PË. Jo, vetëm më tha që ishin dokumente të përgjithshme, me  
7 Shtabin e Përgjithshëm, pra, punë dhe që ai kishte bërë me  
8 këta gjeneralë. Ishte thjesht informacion i përgjithshëm.

9 PY. Le të kalojmë te një tjetër person që ishte prapë një  
10 person që ka qenë i ndaluar bashkë me juve në Bajgorë. Emrin  
11 ky person e kishte Osman Sinani. Në dëshminë e dhënë ju keni  
12 thënë që ai mbase është vrarë në një pikë të caktuar kohe. A  
13 mësuat nga Fadil Sulejviqi që ishte një tjetër person i  
14 ndaluar bashkë me juve se si ishte vrarë Osman Sinani?

15 PË. Këtë e kam dëgjuar nga Fadil Sulejviqi që atë e kishin  
16 rrahur deri në vdekje, e kishin rrahur me shkopinj, sepse  
17 Fadil Sulejviqi kishte qenë në të njëjtën dhomë me të.

18 Domethënë ata të dy kishin qenë në një dhomë bashkë me njëri-  
19 tjetrin. Kur unë dhe Sinani, kur mua dhe Sinanin na dërguan në  
20 pyll për t'u ekzekutuar Sinani u lidh te një pemë, ndërkohë që  
21 unë u lidha në një pemë tjetër. Duart i kishim të lidhura. Dhe  
22 e dëgjova kur ata thanë që a do ta pranosh që ke bashkëpunuar  
23 me serbët dhe ai tha, jo, nuk kam bashkëpunuar asnjëherë me  
24 serbët. Ishte shoqëruar me serbët. Unë e njihja personin nëpër  
25 kafene se e kisha parë si në kafene shqiptare ashtu edhe

1 serbe. Më pas dëgjova një të shtënë. Nuk mund të jem i sigurt,  
2 sepse ka dy versione, por një prej ushtarëve më erdhi aty  
3 pranë dhe më tha, hape gojën. Unë e hapa gojën. Më pas ai më  
4 tha, a e pranon se ke punuar dhe ke qenë agjent për policinë  
5 dhe ushtrinë. Unë nuk e kisha bërë kurrë një gjë të tillë,  
6 thjesht kam qenë roje pylli dhe detyra ime ishte që të  
7 kujdesesha për pyllin. Ai më pas më shtiu në drejtimin tim,  
8 por arma nuk kishte plumb, ishte bosh. Ai më tha që, kur të  
9 bëhesh i hollë sa një skilipec atëherë do të të vrasim.  
10 Domethënë kur të torturojmë deri në fund atëherë do të të  
11 vrasim.  
12 PY. Le t'i kthehemi asaj çfarë të ka thënë Fadil Sulejviqi,  
13 sa i takon Osman Sinanit. Ai të ka thënë që Osmanin e kishin  
14 rreh me shkopinj, shufra hekuri. A të tregoi ty ai se kush e  
15 kishte rrahur Osman Sinanin?  
16 PË. Sulejviqi thjesht më tha se atij i kishin dhënë urdhër ta  
17 bënte këtë gjë që ai gjithmonë merrte urdhra nga Latif Gashi,  
18 sepse ne ishim nën kontrollin e tij. Domethënë personi që na  
19 kontrollonte ne ishte Latif Gashi, ishte përgjegjës. Kishte  
20 edhe shumë persona të tjerë aty.  
21 PY. Për momentin të përqendrohemi tek ajo çfarë të ka thënë  
22 Fadil Sulejviqi për vrasjen e Osman Sinanit. Për të qenë të  
23 qartë, Fadil Sulejviqi a të ka treguar ty se kush e ka rrahur  
24 Osman Sinanin deri në vdekje me shkopinj? A ta ka thënë këtë  
25 gjë Fadil Sulejviqi?

1 PË. Ushtria, sa i takon faktit se kush e ka dhënë urdhrin nuk  
2 ju them dot. Ushtria e ka vrarë atë.

3 PY. Në rregull.

4 PË. UÇK-ja.

5 PY. Kur jua tha këtë gjë Fadil Sulejviqi?

6 PË. Ai ma tregoi këtë pasi na nxorën, pasi na liruan. Ndoshta  
7 pas disa ditësh, 5-6 ditë pasi na nxorën për t'u qëlluar, për  
8 t'u shtirë. Unë nuk e di në qoftë se Fadil Sulejviqi ishte i  
9 ndaluar apo në qoftë se ai ka qenë një lloj agjenti sekret,  
10 sepse askush nuk e rrahu atë. Askush nuk e preku me dorë atë  
11 dhe ai mundte të fliste me të gjithë, ndërkohë që ne të tjerët  
12 nuk flisnim dot.

13 Unë nuk guxoja të flisja me askënd. Në qoftë se Latif  
14 Gashi vinte për të marrë në pyetje ky ishte çasti i vetëm kur  
15 unë mund të flisja. Dhe më vonë më çuan që të rrija me  
16 Sulejviqin. Kur shkuam në tualet që ishte jashtë edhe ai ishte  
17 aty përreth ai më tha që Osmani nuk ishte më aty dhe se ishte  
18 vetëm.

19 PY. Në çfarë vendi ka ndodhur kjo?

20 PË. Në Bajgorë.

21 PY. Dëshmitar, dëshiroj që ta ndërroj pak temën. Në dëshminë  
22 që i keni dhënë hetuesit të UNMIK-ut - do ta jap referencën  
23 për një çast - keni përmendur diçka lidhur me një marshall  
24 gjykate të UÇK-së.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dëshiroj që të jap dokumentin



1 për identifikim dhe dua që t'i referohem një citimi aty. Në  
2 versionin në anglisht është dokumenti SPOE00123186 deri në  
3 00123218 RED, në faqen 20 dhe 21. Pra, është SPOE0012305 deri  
4 në SPOE00123206. Versionet në gjuhën shqipe janë në faqet  
5 përkuese 23 dhe 24 në dokumentin me numër identifikimi  
6 SPOE00123244 deri në SPOE00123245. Nuk është e nevojshme që ta  
7 tregojmë në ekran këtë dokument.

8 PY. Dëshmitar, në atë dëshmi që ia ke dhënë gjykatësit hetues  
9 të UNMIK-ut ke thënë këtë për Gjykatën Ushtarake:

10 "PY. A ke pas një seancë gjyqësore të mirëfilltë në këtë  
11 Gjykatë Ushtarake?".

12 "PË. Ka pas një gjykatë ushtarake dhe më thanë që do të  
13 më çonin para saj te shkolla e Bajgores. Nuk e di se çfarë  
14 ndodhi. Shkuam deri atje, por pastaj më kthyen mbrapsht".

15 Dhe diçka të ngjashme ke thënë edhe të premtën që është  
16 shënuar në një shënim përgatitor. A ke marrë pjesë, a ke qenë  
17 i nxjerrë përpara një gjykate ushtarake, po ose jo.

18 PË. Jo.

19 PY. Në shënimin zyrtar të përgatitjeve të premtën ju thatë se  
20 në një moment ju çuan te shkolla afër fabrikës së HDZ-së, a ju  
21 kujtohet kjo?

22 PË. Po.

23 PY. A mund t'i thoni Gjykatës --

24 PË. Po, më kujtohet.

25 PY. A mund t'u thoni Gjykatësve se çfarë ndodhi aty?

1 PË. Aty më çuan dy ushtarë, aty te shkolla, ku është afër  
2 edhe fabrika e HDZ-së. Më thanë që aty është gjykata. Hymë në  
3 një dhomë; aty ishte ulur një person më i vjetër, rreth 70-  
4 vjeçar dhe tha që ishte gjykatës. Më pyeti, se pse ndodhesha  
5 aty. Unë i thashë që nuk e dija pse dhe kur thashë që nuk e  
6 dija pse, dikush më godit këtu mbas koke dhe unë rashë në tokë  
7 dhe humba vetëdijen.

8 PY. Në çfarë vendi ndodhej kjo në Bare, në Bajgore apo në  
9 ndonjë vend tjetër?

10 PË. Në Bare.

11 PY. A të kujtohet përafërsisht se kur ndodhi kjo?

12 PË. Nuk më kujtohet data e saktë. Kanë kaluar 24, 25 vjet nga  
13 ajo ngjarje. Nuk më kujtohet data e saktë. Por duhet të jetë,  
14 nuk më kujtohet saktësisht.

15 PY. Në rregull. Në qoftë se nuk ju kujtohet diçka thjesht  
16 thoni që s'ju kujtohet. Faleminderit.

17 Thatë që ju nxorën para një personi që u prezantua se  
18 ishte gjykatës. A e njihnit atë person?

19 PË. Jo.

20 PY. A u tregoi emrin apo nofkën?

21 PË. Jo, jo. Asgjë nuk tha.

22 PY. Në qoftë se ju kujtohet, sigurisht, për çfarë ju akuzonin  
23 ky personi, për çfarë ju akuzonte?

24 PË. Më kujtohet shumë mirë më akuzonin se isha një agjent,  
25 një person që punonte për policinë dhe ushtrinë dhe që nuk

1 ishte pylltar. Unë thjesht isha një pylltar; bëja rojën në  
2 mënyrë që drunjtë mos priteshin. Thjesht ata më konsideronin  
3 si një agjent dhe jo pylltar.

4 PY. Po ju si u përgjigjtë ndaj atyre akuzave? Çfarë i thatë  
5 atij personi, atij gjykatësi?

6 PË. I thashë që nuk isha se nuk më interesonte as ushtria e  
7 as policia se vetëm më interesonte puna dhe se për atë gjë  
8 merrja rrogë, si pylltar.

9 PY. Sa kohë zgjati ky i ashtuquajtur gjykim?

10 PË. Nuk u kuptuam, ndoshta e kishin fjalën për gjykimin.

11 PY. Kërkoj ndjesë se nuk isha i qartë në pyetjen time. E  
12 diskutuam këtë situatë kur u gjendët përpara një gjykatësi në  
13 Bare. Pyetja ime është se sa koha zgjati ky proces?

14 PË. Një minutë ndoshta. Jo më shumë se aq. Ai më pyeti a kam  
15 punuar për policinë ose ushtrinë. I thashë, jo, unë jam  
16 pylltar dhe pastaj dikush më ra këtu mbrapa kokës me  
17 automatik, me dhe unë rashë në tokë dhe humba vetëdijen. Kaq  
18 zgjati i gjithë ky proces.

19 PY. Tani të kalojmë te një temë tjetër. Sot më herët mendoj  
20 që përmendët një person me emrin Latif Gashi. A është e saktë?  
21 Gjithashtu, e keni përmendur edhe në disa dëshmi të tjera që  
22 keni dhënë --

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj që  
24 dëshmitari nuk dha përgjigje në pyetjen që e bëtë.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

1 PY. Dëshmitar, cila është përgjigja juaj në këtë pyetje? Sot  
2 më herët mendoj që përmendët një person me emrin Latif Gashi.  
3 Cila është përgjigjja juaj në këtë pyetje?

4 PË. Po, e saktë.

5 PY. Z. Dëshmitar, kur t'ju bëj pyetje edhe në qoftë se e  
6 konfirmoni me tundje koke, përgjigjen, ju lutem, që ta thoni,  
7 edhe me zë përgjigjen. Pra, përgjigjuni me "po" ose "jo", për  
8 hir të procesverbalit. Faleminderit.

9 Dëshmitar, a mund t'i tregoni Gjykatësve se kur për herë  
10 të parë e takuat Latif Gashin, gjatë kohës që ju mbajtën i  
11 ndaluar?

12 PË. E keni fjalën gjatë kohës që isha i ndaluar?

13 PY. Po. Pikërisht për atë kohë.

14 PË. Për Latif Gashin kuptova tri ditë më pas në Bare kur  
15 erdhi Berisha. Ai më tregoi që edhe atë e kishte rrahur Latif  
16 Gashi. Pra, edhe mua edhe atë. Ai ishte përgjegjës për ne të  
17 dy.

18 PY. Ta qartësojmë këtë. E keni fjalën për Sabit Berishën, ai  
19 që mbahej i ndaluar bashkë me ju?

20 PË. Po. Sabit Berishën. Për të e kam fjalën.

21 PY. Ju sa na treguat se Sabit Berisha ju kishte treguar pasi  
22 për këtë pasi ishte kthyer vetëdija. Pse kishte ndodhur  
23 kështu?

24 PË. Atë e kishin rrahur dhe pastaj e sollën aty tek unë dhe  
25 më thanë ja ku e ke vllaun tënd serb.

1 PY. Në çfarë vendi ndodhi kjo?

2 PË. Në Bare me 21 gusht.

3 PY. Për ta bërë të qartë, për herë të parë kur e dëgjuat  
4 emrin e Latif Gashit, kjo ishte në Bare, pasi Sabit Berisha,  
5 pasi Sabit Berishës iu kthye vetëdija, a është kjo e saktë?

6 PË. Po.

7 PY. Gjatë kohës që u mbajtët i ndaluar dikush tjetër përveç  
8 Sabit Berishës, a ju treguan në qoftë se për këtë person se e  
9 kishte emrin Latif Gashi?

10 PË. Këtë e kuptova më vonë, e mora vesh më vonë, ku prej  
11 Bares na transferuan në Bajgorë. Këtë ma tregoi Fadil  
12 Sulejviqi. Ai më tha se i njihte të gjithë se kishte punuar në  
13 Prishtinë për Sigurimin e Shtetit.

14 PY. Çfarë ju tha Fadil Sulejviqi në lidhje me Latif Gashin  
15 dhe pozitën e tij?

16 PË. Më tha që ishte një oficer i ushtrisë, pse më kishte  
17 rrahur kaq shumë kur unë nuk kisha bërë kurrfarë gabimi. Isha  
18 thjesht një pylltar.

19 PY. Dëshmitar, përpara se t'ju mbanin në ndalim në Bajgorë në  
20 Bare dhe në Lupq, a e kishit takuar ndonjëherë Latif Gashin?

21 PË. Nuk e di. Çdoherë që më nxirrnin jashtë i kisha sytë e  
22 lidhur.

23 PY. Të jemi të qartë. Nuk po ju bëj pyetje në lidhje me kohën  
24 kur jeni mbajtur i ndaluar. E kam fjalën përpara asaj kohe.

25 Domethënë pyetja ime është: Përpara se t'ju ndalonin a e kishte

1 takuar ndonjëherë Latif Gashin?

2 PË. Këtë nuk mund ta di se çdo herë i kam pas sytë e lidhura,  
3 por nga zëri ma ka marrë mendja që ka qenë Latif Gashi ai që  
4 më merrte në pyetje.

5 PY. Kush është Hamdi Gashi?

6 PË. Hamdi Gashi është xhaxhai i Latif Gashit. Edhe ai ishte  
7 pylltar.

8 PY. Nga e njihni Hamdi Gashin?

9 PË. Kemi punuar bashkë. Edhe Hamdi Gashi ishte pylltar si  
10 unë.

11 PY. Po përpara se t'ju ndalonin a kishe shkuar ndonjëherë për  
12 vizitë te Hamdi Gashi?

13 PË. Nuk e kuptova pyetjen.

14 PY. Gjatë javëve, muajve apo viteve para se t'ju ndalonin, a  
15 ka ndodh ndonjëherë që ke shku për vizitë te shtëpia e Hamdi  
16 Gashit?

17 PË. Po. Edhe kam fjet te shtëpia e tij më shumë herë. Pra,  
18 tek Hamdi Gashi.

19 PY. Ku jetonte Hamdi Gashi?

20 PË. Në Dobërdol.

21 PY. Thatë që ishte xhaxhai i Latif Gashit, ky person?

22 PË. Po.

23 PY. Kur ke shku për vizitë te shtëpia e Hamdi Gashit, a e ke  
24 parë ndonjëherë aty Latif Gashin, a ka ndodh ta shohësh  
25 ndonjëherë aty?

1 PË. Ndoshta nja dy herë aty në oborr. Unë personalisht nuk e  
2 kam njohur.

3 PY. Në gjykimin e Latif Gashit e të tjerëve në vitin 2002, në  
4 2003, 2009 dhe më pas në 2019, në atë gjykim, në ato gjykime  
5 keni dëshmuar se Latif Gashi ishte komandant i UÇK-së, e  
6 saktë?

7 PË. E saktë.

8 PY. A mund t'i thoni Gjykatësve se çfarë keni parë apo  
9 përjetuar që ju ka shti të mendoni apo të besoni se Latif  
10 Gashi me të vërtetë ishte një komandant i UÇK-së?

11 PË. Të gjitha urdhrat vinin nga Latif Gashi. E di, p.sh. për  
12 gjashtë persona të cilët u arrestuan më pas. Ai urdhëroi  
13 ushtarët që t'i merrnin dhe t'i çonin grupuar istikame. Këtë e  
14 mësova nga Fadil Sulejviqi sepse ai i njihte të gjithë. Ai  
15 kishte punuar në sigurimin e shtetit në Prishtinë dhe i njihte  
16 të gjithë dhe çfarë pune bënin.

17 Tani në qoftë se Fadil Sulejviqi ishte një i arrestuar si  
18 ne apo vetëm e kishin vënë aty në mesin tonë këtë nuk mund  
19 t'jua konfirmoj.

20 PY. Tani dua të më qartësoni dy gjëra: A të ka treguar  
21 ndonjëherë Fadil Sulejviqi për faktin se Latif Gashi ishte  
22 komandant?

23 PË. Po.

24 PY. Kur ta tregoi këtë Fadil Sulejviqi?

25 PË. Në Bajgorë.

1 PY. Ju përmendët një rast kur gjashtë persona shqiptarë u  
2 morën me urdhrin e Latif Gashit. A mund t'i thoni pak më shumë  
3 në lidhje me këtë Trupit Gjykues?

4 PË. Nuk e di se ku i çuan, por Sulejviqi më pas më tregoi se  
5 i kishin çuar për të hapur bunkerë në mal.

6 PY. T'i kthehemi këtij incidenti shkurtimisht. Ju vetë e patë  
7 Latif Gashin duke dhënë urdhra në lidhje me këtë?

8 PË. Ishin disa ushtarë dhe ai i urdhëroi që t'i çonte këta  
9 personat në mal për të hapur bunkerë. Këtë e tha Latif Gashi  
10 dhe ushtarët i morën ata, i çuan atje dhe në mbrëmje i kthyen  
11 përsëri aty.

12 PY. Po ju vetë e patë me sytë, me sy Latif Gashin duke dhënë  
13 urdhra, duke iu dhënë urdhër këtyne ushtarëve të UÇK-së për  
14 t'i çuar këta civilë në mal për të hapur bunkerë? E dëgjuat ju  
15 këtë vetë?

16 PË. Ishte në atë dhomën ku rrinim ne. Aty iu dha urdhër. Unë  
17 aty nuk e kam kuptuar se çfarë urdhri iu dha, mirëpo, atë ma  
18 përktheu Sulejviqi. Tha që, po i çojnë për të hapur bunkerë.  
19 Unë dhe Berisha, meqë ishim të rrahur, nuk ishim në gjendje  
20 për të shkuar dhe për të hapur bunkerë. Edhe Berisha, Sinani,  
21 apo Sinan Berisha ma tha të njëjtën gjë; ma përktheu të  
22 njëjtën gjë se i kishin marrë ata persona për t'i çuar në mal  
23 për të hapur bunkerë.

24 PY. Ishte në praninë tuaj kjo, pra, kur Latif Gashi dha atë  
25 urdhër?



1 Z. KËRVESHI: [Përkthim] Kundërshtim. Është pyetje  
2 orientuese.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Refuzohet  
4 kundërshtimi.

5 Vazhdoni Prokuror.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

7 PY. A mund t'i përgjigjeni pyetjes, a ishit ju i pranishëm  
8 kur Latif Gashi dha këtë urdhër?

9 PË. E saktë. Ishte, kjo ndodhi në të njëjtën dhomë ku ishim  
10 të shtrirë ne. Aty i dha ai këto urdhra.

11 PY. Në dëshmitë që keni dhënë në gjykatë në 2002, 2003 dhe  
12 2009 ju keni thënë që Latif Gashi ju ka rrah edhe ju, a është  
13 kjo e saktë?

14 PË. Është e saktë që ai ka dhënë urdhër për të më rrahur.  
15 Mirëpo, unë i kam pasë sytë e lidhura, kështu që mund të më  
16 ketë rrah edhe ai. Mirëpo, ka dy versione: njëri se ai ka  
17 dhënë urdhra, sepse ishte përgjegjës dhe ndoshta edhe më ka  
18 rrah edhe vetë ndonjëherë. Me 21 gusht ai ishte i përfshirë në  
19 rrahjen time dhe të Berishës në mbrëmje. Ne u rrahëm aq shumë  
20 sa që unë mendoj edhe ai ishte pjesë e grupit që na rrahën atë  
21 natë.

22 PY. A e keni dëgjuar Latif Gashin, duke dhënë urdhra për t'ju  
23 rrahur?

24 PË. Jo, asgjë. Ata përnjëherë hynë në dhomë siç ishim duke  
25 ndenjtur. Unë nuk mundesha të rri në këmbë, isha në gjunjë dhe

1 filluan të më binin këtu përmbropa me shkop gome, me kondakët  
2 e pushkëve dhe kështu me radhë. Por e kam dëgju zërin e Latif  
3 Gashit dhe nuk e kam kuptuar se çka ka thënë, sepse nuk flas  
4 shqip.

5 E di që një person erdhi dhe tha, ma lini mu; unë do ta  
6 vras këtë, t'ia qi nënën serbe, dhe doli nga dhoma. Këtë e di.  
7 PY. A e keni dëgju Latif Gashin, duke dhënë urdhra për t'ju  
8 rrahur?

9 PË. Sigurisht që ka dhënë, sepse ishim aty unë dhe Sabit  
10 Berisha.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Më duhet një minutë vetëm sa të  
12 konsultohem me kolegët e mi, sepse sistemi siç duket nuk punon  
13 siç duhet.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

15 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju faleminderit për durimin dhe  
17 kërkoj ndjesë për këtë ndërprerje.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, tani do të kaloj në një temë tjetër.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A mund të vendosim në ekran  
22 deklaratën me numër ERN U0023926 deri në U0023928 dhe versioni  
23 në anglisht mban të njëjtin numër me shtesën -ET në fund.

24 PY. Dëshmitar, në qoftë se e ke atë dosjen para do ta gjeni  
25 këtë në nënndarjen 7 të dosjes, këtë dokument. Dëshmitar,

1 shiko me kujdes këtë dokument, këtë nga ana e majtë, a e ke të  
2 njohur këtë deklaratë?

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A mund t'i tregohet edhe data e  
4 dokumentit dëshmitarit, është në krye të faqes.

5 PY. Dëshmitar, a e ke të njohur këtë dokument?

6 PË. Unë këtë dokument nuk e kam nënshkruar. Jo.

7 PY. Ky dokument mban datën 26 shtator 1998 dhe kjo është data  
8 kur u liruat. A është kjo e saktë?

9 PË. Po, është e saktë se u lirova, mirëpo ky dokument nuk  
10 është dokumenti im. Nuk e kam nënshkruar unë; nuk e di se kush  
11 e ka nxjerrë këtë dokument; kush e ka dhënë këtë dokument.

12 PY. Në këtë dokument, siç e shihni, në krye të faqes nga ana  
13 e majtë, thuhet se dokumenti e ka lëshuar një degë e  
14 Ministrisë së Punëve të Brendshme në Podujevë. Pyetja ime  
15 është: A u takove me dikën nga policia serbe në Podujevë atë  
16 ditë?

17 PË. Po, e saktë, por jo më shumë se gjysmë minutë. Nuk kam  
18 dhënë unë kurrfarë deklaratë, sepse isha aq i sëmurë sa që nuk  
19 isha në gjendje të jap kurrfarë deklaratë. Të nesërmen në  
20 gazeta doli, u përshkrua se si kisha ikur nga UÇK-ja dhe  
21 kështu me radhë. Nuk e di se çfarë kanë shkruar gazetatat, por  
22 unë nuk kam pas kurrfarë lidhje me këtë. Unë askund nuk kam  
23 dhënë deklaratë.

24 PY. E kam të qartë. Dëshmitar, shkurtimisht a mund t'i  
25 përshkruash Gjykatës se si ndiheshit atë ditë fizikisht dhe

1 mendërisht?

2 PË. Pothuajse nuk dija gjë për veten; aq isha i sëmurë. Aq  
3 isha në gjendje të keqe sa fizikisht saqë është e pamundur që  
4 këtë dokument deklaratë t'ia kisha dhënë dikujt dhe këto e  
5 them me siguri të plotë. Nuk e di se kush e ka shkruar këtë  
6 dokument.

7 PY. Mund ta heqim dokumentin nga ekрани.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Unë do t'ju paraqes edhe një  
9 deklaratë tjetër, Dëshmitar. Ta vendosim në ekran dokumentim  
10 me numër 112054 deri 112057, 58. Ky është versioni në  
11 serbisht, origjinali. Përkthimi në anglisht është dokumenti me  
12 të njëjtin numër me shtesë -ET në fund. T'i vendosim të dy  
13 dokumentet në ekran.

14 PY. Dëshmitar, nga ana e majtë në ekran ke versionin në  
15 serbisht të dokumentit që është Shënim Zyrtar i një interviste  
16 të zhvilluar më 1 tetor 1998. E kemi diskutuar këtë dokument  
17 gjatë takimit seancës përgatitore kur u takuam. Pra, të  
18 premtën që shkoi. Ju kujtohet kjo që e diskutuam këtë  
19 dokument? Thjesht më thoni, në qoftë se ju kujtohet, se e kemi  
20 diskutuar konkretisht këtë dokument.

21 PË. Po.

22 PY. Dëshmitar, ky dokument, siç thashë, mban datën 1 tetor  
23 1998 që është gjashtë ditë pas lirimit tuaj nga UÇK-ja,  
24 mbajtja në ndalim nga UÇK-ja. A mund t'i përshkruani Gjykatës  
25 se si ndiheshit atë ditë më 1 tetor 1998? Ndihehit njëlloj

1 sikurse na e përshkruat para disa minutave?

2 PË. Ndihesha shumë keq. Ndoshta nuk i kam përmendur disa  
3 gjëra. Mirëpo, në atë kohë isha aq keq në gjendje aq të keqe  
4 dhe i shqetësuar, sa që ndoshta nuk kam mund t'i them të  
5 gjitha; nuk më kujtoheshin të gjitha. Të thuash për një muaj,  
6 afërsisht nuk kam qenë në gjendje të flas as me familjen time,  
7 me gruan e me fëmijët.

8 PY. E kuptueshme. Por a ju kujtohet në qoftë se në atë kohë  
9 ju çuan për trajtim mjekësor dikund, në ndonjë institucion  
10 mjekësor?

11 PË. Po, më çuan në një institucion mjekësor.

12 PY. Në cilin?

13 PË. Në një spital në Prokuplje. Më çuan, siç thotë  
14 dëshmitari, në bazë nervore.

15 PY. A ju kujtohet, po flas pak a shumë në atë periudhë. A ju  
16 kujtohet pas sa ditësh apo kur ju çuan në këtë institucion  
17 mjekësor, tetor?

18 PË. Nuk më kujtohet me saktësi. Por nuk ka qenë shumë kohë më  
19 mbrapa. Më mbrapa pasi më liruan, domethënë.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Sekretare e Gjykatës, tek i  
21 njëjti dokument, a mund të shkojmë te faqja e fundit në të  
22 dyja versionet. Pra, në të dyja versionet 1120589 [sipas  
23 përkthimit]. Besoj se ky është numri i saktë i faqes.

24 PY. Dëshmitar, kjo është faqja e fundit e shënimit dhe poshtë  
25 numrit romak V thuhet. Ju mund ta lexoni edhe vetë, por po jua

1 lexoj edhe unë dhe po citoj:

2 "Është e qartë që burimi ende vuan nga probleme nervore  
3 dhe ka lëndime të rënda në brinjë dhe në veshkë. Ende nuk i  
4 besohet që është liruar".

5 Kjo pjesa që sapo lexova, a reflekton vërtet mënyrën se  
6 si jeni ndierë ju atë ditë?

7 PË. Nuk ju kuptova. A mund ta përsërisni pyetjen?

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do jua lexoj edhe një herë se  
9 mbase u hutua pak dëshmitari.

10 PY. Mos e shihni, mos e shihni fare ekranin, por dëgjo  
11 përkthimin që do marrësh në kufje, ndëgjuese. Tek shënimi që  
12 është i 1 tetorit 1998, është një fragment që është për ju.  
13 Është poshtë numrit romak V. Thuhet aty, citoj:

14 "Është e qartë që ende ka probleme nervore dhe se ka  
15 lëndime të rënda në brinjë dhe në veshkë. Ende nuk i besohet  
16 që e kanë liruar".

17 Kjo pjesa këtu që sapo lexova a tregon vërtet mënyrën si  
18 jeni ndierë ju atë ditë? A jeni ndierë vërtet kështu atë ditë?

19 PË. Pak a shumë ky përshkrim është tamam.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më jepni  
21 një çast të konsultohem me kolegët lidhur me një aspekt,  
22 shkurtimisht.

23 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit për durimin. Nuk  
25 kemi edhe shumë pyetje.

1 PY. Dëshmitar, pyetja e fundit lidhur me këtë dokument. Në  
2 këtë deklaratë që ju thashë është dhënë më 1 tetor 1998, nuk e  
3 keni përmendur Latif Gashin. As komandantin tjetër që e kishte  
4 emrin Nuredin Ibishi. Pse nuk i thatë këto emra, a mund t'i  
5 tregoni Trupit Gjykues?

6 PË. Kur kam dhënë këto deklaratë, këtë deklaratë e kisha  
7 harruar në atë kohë shumë gjëra. Edhe akoma nuk isha  
8 plotësisht i ndërgjegjshëm; kisha kaluar shumë, kisha pasur  
9 shumë trajtime mjekësore. Pak më vonë kur e mora një çikë  
10 veten u kujtova për komandantët.

11 PY. Thatë që harruat. A mund t'i sqaroni Trupit Gjykues, pse,  
12 cila ishte arsyeja pse nuk i thatë emrat? Ishte për arsye  
13 psikologjike, kishte arsyeja të tjera, përmendët barnat që  
14 kishit marrë, por emrat e këtyre personave nuk i thatë të  
15 Latif Gashit, Nuredin Ibishit në deklaratën tuaj, cila qe  
16 arsyeja konkrete për të?

17 PË. Arsyeja kryesore kjo ishte, sëmundja ime, gjendja ime.  
18 Për shkak të sëmundjes nuk e përmenda dot as Latif Gashin dhe  
19 as Nuredin Ibishin.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Sekretare, mund ta hiqni nga  
21 ekrani dokumentin dhe do kërkoja që tani në ekran të vendosni  
22 një dokument që ka numrin ERN 113511 deri në 113522 dhe kjo  
23 është serbishtja. Ndërsa në të djathtë i njëjtë dokument me ET  
24 në fund që është përkthimi në anglisht. Në qoftë se nuk është,  
25 nuk është nevoja ta shfaqin në ekran.

1 PY. Dëshmitar, të enjten e javës së kaluar, më 15 qershor,  
2 Prokurorisë i treguat kartelën mjekësore që e kishe sjellë me  
3 vete nga Serbia. A ju kujtohet?

4 PË. Po, më kujtohet.

5 PY. Çfarë përmbante kjo kartelë që na tregove? Çfarë  
6 dokumentacioni ishte ky, që na tregove ditën e enjte,  
7 shkurtimisht?

8 PË. Ishte raporti forenzik nga Instituti i Forenzikës në  
9 Nish. Pra, e kishte kërkuar Gjykata e Prokupljes; ishte  
10 raporti i forenzikës ku vërtetohej nëse isha në gjendje apo jo  
11 për të vepruar dhe cilat ishin kushtet e mia.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

13 PY. Më në përgjithësi, ky ishte një dokumentacion që tregonte  
14 gjendjen tuaj fizike, kushtet tuaja fizike?

15 PË. Po gjendjen time fizike. Po edhe gjendjen time  
16 shëndetësore.

17 PY. Në këtë raport flitej edhe për kushtet tuaja mendore apo  
18 psikologjike?

19 PË. Po.

20 PY. Ky dokumentacion lidhej me keqtrajtimin edhe ndalimin që  
21 ju ka bërë UÇK-ja ju në vitin 1998?

22 PË. Po.

23 PY. Dokumenti thotë në tre raste dhe tri vende, në qoftë se e  
24 lexon, jeni shtruar tri herë në spital për probleme  
25 psikologjike në pavijonin e neuropsikiatrisë të Qendrës



1 Mjekësore të Prokopljes, kështu?

2 PË. E saktë.

3 PY. Kur e sheh këtë dokument, por në përgjithësi, përmenden  
4 edhe problemet fizike; flet për brinjë të thyera, dhimbje në  
5 mes, në fund të mesit, probleme me veshkat, probleme me  
6 urinimin, në rrugët urinare. Këto aspekte që përmenden në këtë  
7 dokumentacion a lidhen, apo a vijnë për shkak të ndalimit  
8 tuaj?

9 PË. Po.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoja  
11 që këtë dokumentacion të paraqiten, të pranohen si prova.  
12 Besojmë se janë me rëndësi; janë autentikë, i ka vërtetuar  
13 dëshmitari; kanë vlerë provuese, si dhe kanë natyrë  
14 konfirmuese, sa u takon provave të tjera në lidhje me këtë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'u  
16 japin shënimin për identifikim, por deri në momentin që do  
17 marrim përkthimin, nuk do të vendosim.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në fakt, përkthimi është gati.  
19 Besoj që i është dhënë Mbrojtjes. Thjesht s'e kemi aktualisht  
20 në listën e prezantimeve, një problem teknik për të cilin  
21 kërkoj ndjesë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në momentin  
23 që do ta shohim do marrim edhe vendimin.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E qartë, faleminderit.

25 Kalojmë te tema e fundit e pyetjeve që kemi ne për sot. A

1 mund të vendosim në ekran një dokument SITF00243117 deri në  
2 SITF00243117. Kjo është anglishtja e dokumentit, ndërsa  
3 shqipja është pak më e madhe. Është SITF00243091 deri në  
4 00243150. Dhe do të jetë konkretisht faqja 27. Më duket se  
5 përpara kemi serbishten dhe anglishten, por nëse mund të  
6 vendosim dhe shqipen në të majtën do ishte diçka shumë e mirë  
7 me numrin SITF00243091 deri në 00243150 është dokument i madh,  
8 voluminoz. Faqja 27. Fiks. Ky është dokumenti.

9 PY. Dëshmitar, përpara keni një dokument në shqip në të majtë  
10 edhe anglisht në të djathtë. Te dosja e ke te nënndarja 11  
11 përpara. Do flasim, kemi folur shumë për këtë dokument.  
12 Megjithatë, do t'ju lutesha të më thoni nëse janë të sakta  
13 korrigjimet që keni bërë dhe do ju bëj disa pyetje lidhur me  
14 këtë.

15 Emri dhe mbiemri, një herë, a janë të saktë, siç e shihni  
16 këtu?

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Më falni. A mund ta ndihmojmë  
18 dëshmitarin që të hapë dosjen që ka përpara, sepse ka  
19 serbishten përpara, në kopje fizike. Nënndarja me numër 11.

20 PY. Dëshmitar, shihni dosjen dhe përgjigjuni pyetjes sime.  
21 Mos e shihni ekranin; ekрани është për pjesëmarrësit në sallën  
22 e gjyqit, për Trupin Gjykses, për Mbrojtjen.

23 Emri dhe mbiemri në dokument, a janë të saktë? Shihni  
24 dosjen që keni përpara.

25 PË. E saktë.

- 1 PY. Po emri i babait?
- 2 PË. Aleksandër. E saktë është.
- 3 PY. Vendi dhe data e lindjes siç janë këtu në dokument, a
- 4 janë të sakta?
- 5 PË. Janë të sakta, por s'e kam shkruar unë këtë dokument.
- 6 PY. Në rregull. Kombësia juaj a është e saktë, siç është
- 7 thënë në këtë dokument?
- 8 PË. Është e saktë. Jam serb.
- 9 PY. A ka qenë adresa juaj asokohe, është e saktë?
- 10 PË. Kjo është adresa që kam pasur në Podujevë. E saktë është.
- 11 Atë adresë kam pasur kur punoja atje.
- 12 PY. Por punëdhënësi juaj Javor, kompania Javor në Podujevë, e
- 13 saktë është?
- 14 PË. E saktë.
- 15 PY. A ke punuar vërtet në Slloveni për një periudhë kohore
- 16 sikurse dhe thuhet në këtë dokument?
- 17 PË. Është e saktë. Kam punuar 22 vjet në zyrën postare atje.
- 18 PY. Në fund të faqes jepet informacion për Hamdi Gashin, që
- 19 ka punuar me ju personalisht. Është i saktë informacioni këtu?
- 20 PË. E drejtë është, ka punuar me mua dhe ai pylltar ka qenë.
- 21 PY. E kuptoj që s'e ke shkruar ti këtë dokument, por a ia ke
- 22 dhënë ti këto informata UÇK-së gjatë kohës që të mbanin të
- 23 ndaluar?
- 24 PË. Jo, nuk më kujtohet që t'i kem dhënë unë këto informata.
- 25 Ata kishin letërnjoftimin tim.

1 PY. UÇK-së, gjatë kohës që ishe në ndalim, ia ke dhënë të  
2 dhënat personale tuat?

3 PË. Jo, kishin letërnjoftimin tim.

4 PY. Por a të pyetën ndonjëherë ta vërtetojë a ishte ky emri i  
5 saktë, vendi i punësimit, datëlindja, vendlindja?

6 PË. Jo, asgjë. Asgjë nuk më pyetën.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Më jepni edhe një çast se më ka  
8 të ngjarë që të kem përfunduar.

9 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë i  
11 përfundoj pyetjet e mia.

12 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Sekretarja kishte nevojë të bënte, të bënte një lidhje me  
15 procesverbalin, për parashtrimin tuaj. A jeni gati?

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po. Pak më herët i  
17 dhashë provës materiale numër P195, me provën materiale të  
18 shoqëruese e paraqitur me ERN 0010504-00110504 [sipas  
19 përkthimit]. Pra, ia dhashë këtë numër më herët. Sidoqoftë, ky  
20 dokument e ka marrë më herët numrin e provës materiale P167.  
21 Prandaj, do t'i japim numrin P95 [sipas përkthimit] sipas  
22 shënime përgatitore që kanë qenë me ERN-në 113598 deri në  
23 113603 dhe do ta heqim numrin P196 dhe do ta përdorim për  
24 dokumentin e radhës që synon të përdorë Prokuroria si provë  
25 materiale.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 I drejtohem i z. Laws.

3 Pyetje nga Z. Laws:

4 Z. LAWS: [Përkthim]

5 PY. Mirëmëngjesi, Dëshmitar.

6 PË. Mirëmëngjesi.

7 PY. Ju më njihni, ne jemi takuar. Unë jam Mbrojtësi i  
8 Viktimave në këtë çështje gjyqësore. T'ju bëj shumë pak  
9 pyetje, në rregull?

10 PË. Në rregull.

11 PY. Shpresoj se ju i kuptoni procedurat, ta kuptoni që  
12 Gjykatësit i kanë deklaratat tuaja e të gjithë i kanë lexuar  
13 ato që ju kanë ndodhur gjatë kohës që keni qenë në ndalim.  
14 Keqtrajtimi, të gjitha ato talljet, kushtet në të cilat keni  
15 qëndruar. Pra, i kemi lexuar dhe i kemi kuptuar. Nuk është më  
16 nevoja t'ju kthehem me hollësi të gjitha këtyre.

17 PË. Në rregull.

18 PY. Po unë dua t'ju bëj disa pyetje për kohën që keni qenë  
19 qëndruar në ndalim. Edhe e para pyetje që kam është kjo: Si  
20 ishte të jetoje 55 ditë i ndaluar nga UÇK-ja? Çfarë përjetove  
21 në këto 55 ditë?

22 PË. Të korrigjoj njëherë se janë 56 ditë. Ka qenë shumë e  
23 vështirë. Ditët e para s'kisha ushqim. Isha diku në mes të  
24 pyllit, në një lloj bunkeri dy metra, dy me një metra. Isha  
25 vetëm unë atje. Atje rrija. Nuk e di ku na çuan për të na

1 marrë në pyetje, në një dhomë. Nuk më kujtohet se kam pasur  
2 sytë e lidhur, të mbyllur. Dhoma ku morën në pyetje, burrat që  
3 ishin atje kishin maska në fytyrë, personat që ishin atje.  
4 Pra, edhe në qoftë se do m'i hiqnin atë që më kishin lidhur  
5 sytë unë s'do njihja asnjë se personat kishin maska që ua  
6 mbulonin fytyrën, si ballaklava, komplet si çorape mbi kokë.  
7 PË. Ju kërkoj ndjesë. Nuk dua t'ju ndërpres, se nuk dua të  
8 dukem i pasjellshëm. Ju thashë ne i kemi lexuar këto. Pyetja  
9 ime nuk është, nuk ka për synim që ju të na përsërisni atë që  
10 keni kaluar. Por do ta bëj pyetjen ndryshe: nëse do të na  
11 përshkruani me pak fjalë tani, si u ndjeve, çfarë përjetove,  
12 jo çfarë ju ndodhi konkretisht, por ti si person çfarë  
13 përjetove kur po të ndodhnin këto gjëra, ato 56 ditë qëndrimi.  
14 PË. Shumë keq u ndjeva. Ndonjëherë kur më rrihnin s'kisha,  
15 isha komplet pa ndjenja. Ishte shumë e vështirë. Është shumë e  
16 vështirë t'i shpjegosh këto.

17 PY. Psikologjikisht, ju pyeti Prokurori, pra, ju pyeti  
18 Prokurori pak më herët si u ndjetë psikologjikisht, dhe ju u  
19 përgjigjët se, "Pothuajse nuk e kuptoja më kush isha". Kjo  
20 është thënë konkretisht në faqen 39, rreshti 22 i transkriptit  
21 provizor. Pra, u përgjigjët, thatë, "S'po e kuptoja më kush  
22 isha". A mund të na shpjegosh çfarë doje të thojë me këto  
23 fjalë?

24 PË. Nga sa më kujtohet, dhe më kujtohet shumica e gjërave, më  
25 dhanë një letër për lirim. Më thanë ta nënshkruaja që, një,

1 s'do shkelja më kurrë në Kosovë, dhe që nuk më kishin rrahur  
2 apo keqtrajtuar. Kjo u përsërit tri herë nga Latif Gashi. Pra,  
3 tri herë ma përsëriti mua dhe më tha, që nëse nuk e firmosja  
4 do më vrisnin dhe unë e firmosa. Ne mbase qe gabimi i madh ta  
5 firmosje, por isha në pozita shumë të vështira. Edhe unë doja  
6 të jetoja. Po mos ta firmosja mbase do më vrisnin se kështu  
7 tha Latif Gashi.

8 PY. Faleminderit. Na thatë që jeni mjekuar në spital për  
9 shkak të gjendjes suaj. E shohim edhe nga dokumentacioni që je  
10 diagnostikuar me depresion, me ankth, gjendje ankthi edhe keni  
11 marrë barna për të trajtuar këtë situatë, kështu?

12 PË. Po, kështu.

13 PY. Po sot, z. Dëshmitar, i merrni ende barnat?

14 PË. Jo, më duhet t'i marr barnat dhe kam prova. Unë s'do isha  
15 gjallë po mos t'i merrja këto barna, sa për sa kohë të rroj  
16 duhet të marr barna sepse vuaj nga trauma.

17 PY. Po ashtu në dokumentacionin që kemi që është konkretisht,  
18 dokumentacioni me numrin SPOE00209 nuk është nevoja ta shfaqim  
19 në ekran, por një doktor ka dalë në përfundimin që ju nuk  
20 ishit më në gjendje pune për shkak të asaj që ju kishte  
21 ndodhur. E saktë është kjo?

22 PË. E saktë është.

23 PY. Ky vendim është marrë në janar 2001. Kanë kaluar shumë  
24 vite. Qysh atëherë s'keni qenë në gjendje të punoni, kështu?

25 PË. Jo. As nuk punova më pasi u lirova. S'isha më në gjendje

1 pune. I kam dhënë dokumentet ku thuhet se në '99 që në '99 u  
2 deklarova, më shpallën që isha i pazoti për punë dhe dola në  
3 pension si person me gjendje të kufizuara apo handikap. Besoj  
4 se i keni ato certifikatat mjekësore.

5 PY. Kaq pyetje kisha.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë bëjmë  
7 pushimin dhe kthehemi në 11.30, pastaj të fillojë z. Kehoe.  
8 Jemi në seancë publike.

9 Asistente, ju lutem, shoqërojeni dëshmitari jashtë sallës  
10 së gjyqit.

11 Z. STRONG: [Përkthim] Dua t'ju njoftoj se ne do na  
12 nevojitet më pak se 1.5 orë, sepse kishim parashikuar më parë  
13 1.5 orë për të pyetur këtë dëshmitar. Më pas se çerek ore  
14 madje mund të them.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Një orë, plus-minus. Një çik më  
17 shumë se një orë qameti.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Njësoj si Mbrojtësi i z. Veseli,  
20 maksimumi 15 minuta.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Mendoj gjysmë ore për momentin.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E vlerësoj  
23 përditësimin që më dhatë.

24 --- Pauza fillon në orën 10.57

25 --- Seanca rifillon në orën 11.30



1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në  
2 seancë publike.

3 Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më dëgjoni,  
6 dëshmitar?

7 DËSHMITARI: Po, ju dëgjoj mirë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të  
9 vazhdojmë me pyetje nga ekipet e Mbrojtjes.

10 Së pari, z. Kehoe.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

12 Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe:

13 Z. KEHOE: [Përkthim]

14 PY. "Dëshmitar", më lejoni të them -- sikurse e tha në fillim  
15 Gjykatësi Smith, në qoftë se ka ndonjë rast që juve nuk e  
16 kuptoni një pyetje, që e bëj unë, ju lutem ma thoni këtë gjë.  
17 Por nga ana tjetër në qoftë se juve nuk keni përfunduar së  
18 dhëni shpjegimin ose përgjigjen e një pyetjeje që ju kam bërë  
19 më përpara, ndërkohë që unë vazhdoj me pyetjen tjetër, mos e  
20 merrni këtë si mungesë respekti, por thjesht më thoni që  
21 s'keni përfunduar me dhënien e përgjigjes. A e kuptoni këtë  
22 gjë?

23 PË. Po.

24 PY. Dëshiroj t'ju pyes pak lidhur me arrestimin tuaj, me  
25 datën 2 gusht 1998. Na treguat më herët se keni qenë në pyll,

1 ishiti roje pylli, dhe punonit në zonën e Velikës së Vjetër.

2 PË. Po.

3 PY. Në fakt në atë kohë keni qenë i armatosur, kështu?

4 PË. Jo, në fakt çdo roje pylli e kishte një armë. Edhe unë  
5 kisha një pistoletë.

6 PY. Meqenëse ra fjala, sa roje të tjera pylli kishte në atë  
7 kohë në atë zonë?

8 PË. Njëmbëdhjetë.

9 PY. Dhe çfarë bënit juve, domethënë, shëtisnit nëpër pyll dhe  
10 ndërmjet të tjerash siguroheshit që të mos priteshin dru pa  
11 leje në pyll, kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Ju kishit veshur një uniformë të gjelbër, kështu?

14 PË. Po.

15 PY. Uniformat e ushtrisë serbe janë me ngjyrë jeshile si  
16 jeshili ulliri, kështu?

17 PË. Nuk e kuptova pyetjen.

18 PY. Thatë që kishit një uniformë në ngjyrë të gjelbër, si  
19 roje pylli.

20 PË. Po, e gjelbër, ashtu e kanë uniformën rojet e pyllit.

21 PY. Dhe uniforma e ushtrisë serbe është me ngjyrë të gjelbër  
22 në -- ngjyrë ulliri.

23 PË. Është pak më e zënë kjo, është domethënë, kjo është  
24 ngjyra e uniformës së ushtrisë.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Të shohim dokumentin SPOE00123186

1 deri SPOE00123218, jam i interesuar të paraqisni dokumentin  
2 205 në versionin në anglisht, dhe besoj që është i njëjti  
3 dokument dhe në versionin serbisht.

4 PY. Pyetja që ju bëri ZPS-ja është kjo:

5 "Si roja pylli, a vishnit uniformë?

6 Ju përgjigjeni:

7 "Po."

8 Pastaj vazhdohet me pyetjen tjetër

9 "PY. A ishte uniformë e ndryshme nga uniformat e  
10 policisë?

11 "PË. Po, jona është me ngjyrë jeshile.

12 "PY. Uniforma ka të njëjtën uniformë si ushtria?

13 "PË. Jo, është e ndryshme, sepse uniformat e rojeve janë  
14 të gjelbra ndërsa uniformat e ushtrisë janë me ngjyrë jeshile  
15 ngjyrë ulliri".

16 A i keni dhënë këto përgjigje ZPS-së?

17 PË. Po.

18 PY. Pra, kur ju shikonit ose kontrollonit pyllin dhe ishit në  
19 këtë uniformë të gjelbër, mund të keni, ose mund të merrnit  
20 informacion që ishte me vlerë për autoritetet serbe që kishin  
21 të bënin për shembull me veprimet e UÇK-së apo pozicionimet e  
22 popullsisë civile. A është e saktë kjo?

23 PË. Jo. Unë nuk kam dhënë asnjë lloj informacioni për askënd.

24 PY. [Nuk ka përkthim]

25 PË. Sepse unë isha përgjegjës që të sigurohesha që nuk

1 bëheshin prerje të paligjshme të pemëve në pyll sepse ndodhnin  
2 shumë aktivitete të ngjashme në pyll.

3 PY. Më lejoni që t'ju jap një koment të një dëshmitari të  
4 ZPS-së, Nuredin Ibishi, që e përmendët edhe sot paradite.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Për këtë do t'i kërkoja Sekretares  
6 që të paraqiste dokumentin SPOE00088341-00088352 në faqen  
7 88349.

8 PY. Nuk kemi versionin në gjuhën serbe të këtij dokumenti  
9 kështu që do ta lexoj për ju, [REDAKTUAR] Z. Ibishi iu bë  
10 pyetje lidhur me [REDAKTUAR]:

11 "Sa i takon [REDAKTUAR], ne kishim një raport që kishte  
12 ndërhyrë me një armë të vogël, një prej pozicioneve tona në  
13 Potok kështu që atë e ndaluan. Mund të them që rojet e njihnin  
14 shumë mirë zonën dhe ndonjëherë i informonin forcat  
15 paraushtarake serbe. Ne kishim marrë informacionin që shumë  
16 prej tyre kishin dhënë informacione të ndryshme shumë të  
17 rëndësishme për serbët lidhur me pozicionin e popullsisë  
18 civile edhe lidhur gjithashtu edhe me veprimet tona  
19 ushtarake."

20 Sa shpesh i raportonit autoriteteve serbe lidhur me  
21 veprimtaritë ushtarake të UÇK-së?

22 PË. Nuk kam raportuar asnjëherë asgjë.

23 PY. Po thoni që gjatë gjithë kohës kur keni punuar si roje  
24 pylli, nuk keni raportuar asnjëherë asnjë lloj informacioni që  
25 kishte të bënte me lëvizjen e civilëve shqiptarë të Kosovës

1 apo të veprimtarive ushtarake të UÇK-së? Nuk keni raportuar  
2 asnjëherë për një gjë të tillë për autoritete serbe, këtë po  
3 thoni?

4 PË. Po, po. Këtë po them, nuk kam raportuar asnjëherë.

5 PY. [Nuk ka përkthim]

6 PË. Vetëm një pyetje ju lutem. Unë u kam raportuar  
7 autoriteteve serbe që po merrnin rërë me kamionë civilë në  
8 Bajgore dhe që po përgatiteshin disa bunkerë. Derisa e pranuan  
9 këtë. Edhe nuk kam shkuar asnjëherë më për të raportuar asgjë  
10 tjetër. Kjo është e vetmja gjë që kam raportuar.

11 PY. Pra, i keni raportuar autoriteteve serbe që civilëve --  
12 dhe do t'ju lexoj atë që sapo thatë. Pra thatë që:

13 "Ju kam raportuar autoriteteve serbe që po merrej rërë me  
14 kamionë civilë për të përgatitur ose për të ndërtuar ca lloj  
15 bunkerësh."

16 Kur e ke raportuar këtë informacion sa i takon ndërtimit  
17 të bunkerëve?

18 PË. Diku nga fillimi i 1998.

19 PY. Përpara se sa të arrestoheshit më datë 2 gusht, ti u  
20 kishe thënë autoriteteve serbe që disa kamionë me civilë, pra,  
21 kishin marrë rërë nga pylli në mënyrë të tillë që të  
22 ndërtoheshin istikame, ose bunkerë siç e thatë ju, kështu?

23 PË. Po, e saktë.

24 PY. Kur ju arrestuan gjatë kësaj periudhe kohe, dhe kur e  
25 dinit që UÇK-ja dhe civilët po ndërtonin istikame, ju ishit në

1 dijeni që po zhvillohej një luftë midis UÇK-së dhe

2 autoriteteve serbe në atë zonë, apo jo?

3 PË. Po, kisha dëgjuar nga kolegët e mi, nga rojtarë të tjerë  
4 pylli që ishin shqiptarë, pra kishin nënshtetësi shqiptare.

5 PY. Pra, jemi në një kohë lufte më datë 2 gusht. I kishit  
6 dhënë autoriteteve serbe informacion lidhur me ndërtimin e  
7 istikameve nga civilët, kishe veshur një uniformë të gjelbër,  
8 ishe roje, kishe gjithashtu edhe një armë. Kështu ka qenë?

9 PË. Po. Por, çdo roje pylli kishte një armë, i jepej që në  
10 ditën e parë të punës një armë. Domethënë, të gjithë rojet e  
11 pyllit, qofshin ato serbë apo shqiptarë, të gjithë kishin një  
12 armë.

13 PY. Na e përmendët, dhe do të futemi pak më në tepër detaje  
14 për pak, por thatë, si fillim, duke i dhënë përgjigje një  
15 pyetjeje të kolegut tim nga ZPS-ja, i cili ju tregoi një  
16 deklaratë nga data 26 shtator 1998, që ishte hartuar një  
17 oficer policie me emrin Vladimir Simic. A ju kujtohet kjo?

18 PË. Nuk e kam shkruar unë atë deklaratë, unë nuk kam dhënë  
19 asnjëherë deklaratë. Sepse ditën më pas, domethënë kjo ka  
20 ndodhur më 26. Ndërkohë që më datë 27 ishte në gazeta që unë  
21 kisha ikur, isha arratisur nga UÇK-ja dhe u shkruan lloj-lloj  
22 gjërash të tjera. Ndërkohë që unë nuk kisha as i vetëdijsëm  
23 në çfarë gjendje isha, e aq më pak të isha në gjendje që të  
24 jepja deklaratë. Nuk kam dhënë asnjë lloj deklarate.

25 PY. Dëshmitar, në fakt ju keni shkruar në rajonin e policisë

1 më datë 26 shtator 1998, apo jo?

2 PË. Po, por më çuan me makinë atje, se unë as nuk ecja dot.

3 Më morën me autobus dhe më dërguan në rajonin e policisë.

4 PY. Ju i thatë Vladimir Simic që -- UÇK-ja po ndërtonte  
5 istikame, kështu? Më datë 26 shtator, ia thatë këtë gjë?

6 PË. Jo, më datë 26 shtator nuk e thashë këtë gjë. Ne  
7 argumentuam, debatua, ia kisha thënë më përpara ndoshta ia  
8 kisha thënë dy ose tre muaj më përpara që po ndërtoheshin  
9 istikame.

10 PY. Më lejoni t'ju tërheq vëmendjen në deklaratën që i keni  
11 dhënë ZPS-së.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Për procesverbal është dokumenti me  
13 ERN 070629 Pjesa 2, përkthimi në anglisht, faqe 16, 13 deri  
14 14. Dhe në versionin në serbisht është me të njëjtin numër  
15 ERN-je, Pjesa 2, faqja 5, 12 deri në 18. Ndërkohë që në shqip  
16 është me të njëjtin numër ERN-je, Pjesa 2, faqja 6 dhe -- nga  
17 6 deri në 12 [sipas përkthimit] pak a shumë.

18 Të nderuar Gjykatës kërkoj që të mos paraqitet në ekranet  
19 për publikun një dokument i tillë, por besoj që është në  
20 rregull që të përmendet emri i dëshmitarit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk duhet  
22 ta përmendësh.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Atëherë do ta lexoj dhe do ta heq  
24 emrin e përveçëm. Emrin e këtij personi, pra dëshmitari në  
25 këtë raport.

1           SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Për procesverbal, të  
2 nderuar Gjykatës, ky dokument ka marrë numrin e provës  
3 materiale P193.2

4           Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit.

5 PY. Më lejoni t'jua lexoj këtë dokument, dëshmitar. Është një  
6 pyetje që ju është bërë nga ZPS-ja.

7           "A ju kujtohet", kjo është një pyetje që ju drejtohet  
8 juve, "a ju kujtohet të keni folur me një oficer serbe në  
9 Podujevë në rajonin e policisë në Podujevë rreth datës 26  
10 shtator 1998, dhe më konkretisht a keni folur me komandantin e  
11 policisë së Podujevës, një farë Zlatimir Simic?

12          "PË. Në datën 26?

13          "PY. Më 26 shtator 1998.

14          "PË. Unë shkova në një stacion policor dhe i thashë: "Ti  
15 nuk je njeri, je qen".

16          "PY. Për kë e kishe fjalën?

17          "PË. Për komandantin, sepse i tregova atij se çfarë po  
18 ndodhte atje, dhe se ata po ndërtonin bunkerë, e gjithçka  
19 tjetër, dhe ai më flaku jashtë zyrës."

20          Pyetje -- ju kërkojë ndjesë, e tërheq. Pyetja që kam tani  
21 është, a ju janë bërë këto pyetje nga ZPS-ja dhe a keni dhënë  
22 përgjigjet që unë sapo lexova?

23 PË. Vetëm këtë që lexuat që nuk ishte qenie njerëzore dhe që  
24 më nxori nga zyra. Vetëm këtë kam dhënë dhe nuk kam thënë  
25 asnjë gjë tjetër përveç kësaj.



1 PY. Ju i treguat ZPS-së në përgjigje të pyetjes që i bëre  
2 Prokurores se, për shkak të faktit që i tregova se çfarë po  
3 ndodhte atje, që ata po ndërtonin bunkerë e gjithçka tjetër”.

4 A i keni thënë Simic më 26 shtator 1998 që UÇK-ja po  
5 ndërtonte bunkerë?

6 PË. Jo, jo atëherë, jo.

7 PY. [Nuk ka përkthim]

8 PË. Unë veç sa i thashë që nuk ishte njeri dhe që ishte  
9 fatkeqësi që ishte komandant i policisë.

10 PY. Kur jua morën këtë dëshmi tuajën dhe kur juve ju kërkua  
11 që të tregoni të vërtetën, a po i thoni Trupit Gjykues që kur  
12 iu përgjigjët ZPS-së, ose në përgjigjet që keni pasur me ZPS-  
13 në, që:

14 “...unë i tregova atij se çfarë po ndodhte atje dhe se  
15 ata po ndërtonin bunkerë e gjithçka tjetër.”

16 Pra kur ia keni thënë ZPS-së këtë gjë, nuk keni thënë të  
17 vërtetën, këtë po thoni? Këtë po i thoni Trupit Gjykues?

18 PË. Unë e kam thënë këtë përpara se të isha ndaluar, ndoshta  
19 tre muaj përpara se të më ndalonin, dhe që kishte të bënte me  
20 bunkerët. Nuk e kam thënë këtë gjë më 26 shtator. Këtij  
21 komandanti nuk ia kam thënë atëherë më 26 shtator.

22 PY. Fatkeqësisht dëshmitar, nuk i keni thënë këtë gjë ZPS-së  
23 kur ju kanë marrë në intervistë. ZPS-së i keni thënë që më 26,  
24 kur u liruat, dhe shkuat në rajonin e policisë, i thatë  
25 policisë që UÇK-ja po ndërtonte bunkerë, kështu?

1 PË. Jo, jo. Nuk është e saktë. Unë them që nuk është e saktë.

2 PY. Ju thoni, pretendoni, gjithashtu që e gjithë intervista  
3 me oficerin e policisë me Simic, pra ti po thua që nuk ke  
4 folur fare me të atë ditë, kështu?

5 PË. Nuk ka qenë e mundur, nuk mund të kem folur me të.

6 PY. Në rregull, shkon në një dokument tjetër.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Numër identifikimi SPOE00123186 deri  
8 në 123289. Ju kërkoj ndjesë, më duket se ju thashë gabim  
9 numrin e dokumentit. Edhe një herë, është dokumenti U002-3926,  
10 3928. Është me të njëjtin numër ERN-je në serbisht, dhe të  
11 njëjtën faqe gjithashtu në versionin në serbisht.

12 PY. Në qoftë se mund ta kalojmë më poshtë dokumentin, besoj  
13 që është një deklaratë trefaqëshe, pra është një deklaratë që  
14 ka të bëjë me hollësitë e arrestimit tuaj.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju lutem, le të kalojmë tek faqja 2.  
16 E vazhdojmë tek faqja tjetër.

17 PY. Pra, është një dokument thuajse dy faqe e gjysmë. Është  
18 një deklaratë dy faqe e gjysmë që oficeri Simic thotë që e ka  
19 marrë prej jush. Nga e ka marrë këtë informacion ky, në qoftë  
20 se s'ia keni dhënë ju, nga e ka marrë tjetër?

21 PË. Jo, komandanti nuk e ka marrë prej meje këtë informacion.  
22 Sepse ditën tjetër, e përsërita, pra ditën tjetër kishte dalë  
23 nëpër gazeta që unë isha arratisur nga UÇK-ja. Unë nuk ia kam  
24 dhënë asnjëherë një deklaratë të tillë, asnjëherë nuk ia kam  
25 dhënë këtë informacion komandantit Simic.

1 PY. Po nga e mori gjithë këtë informacion ky, e keni ndonjë  
2 ide për këtë?

3 PË. Këtë nuk e di. Nuk e di se nga e mori gjithë këtë  
4 informacion. Unë nuk mund ta di unë se nga e ka marrë ai këtë  
5 informacion.

6 PY. [Nuk ka përkthim]

7 PË. Si mund të jetë e mundur që në të njëjtin dokument thuhet  
8 që unë isha arratisur, si mund të isha arratisur unë kur unë  
9 s'kisha mundësi as të hidhja këmbën? Mua më liruan me një  
10 deklaratë, me një dokument që thoshte që unë u lirova.

11 Megjithatë unë nuk e di se çfarë ka marrë, kur, dhe qysh e ka  
12 marrë informacionin ky komandant.

13 PY. Ju na thatë që nuk i keni dhënë informacion komandantit  
14 për bunkerët. Le të shohim pak një dokument.

15 PË. Unë ia kam thënë këtë gjë, ia kam thënë më herët. Ndoshta  
16 tre apo katër muaj më herët. Përpara se sa të arrestohesha.

17 PY. Atëherë, le të shohim në një prej faqeve të mëparshme.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Besoj se jemi më datë 28, kjo është.  
19 Dokumenti 3927 deri 3928. Fundi i faqes.

20 PY. Oficeri Simic shkruan, pas bisedave me ju që keni folur  
21 për UÇK-në:

22 "Kur u pyetën se sa prej tyre ishin sipas vlerësimeve të  
23 tij, dhe çfarë armësh kishin, ai", domethënë ti, "u përgjigje  
24 që ishin thujse 30 policë me uniforma blu të errëta dhe me  
25 rrathë të kuq të cilët e kanë trajtuar mirë. Sa i takon

1 armëve, ai konfirmon që kishin automatikë të lehtë me  
2 municione, edhe mbase armë 7.9 mm. Dhe, ndërkohë ka pasur  
3 rreth 7 automatikë me 20-30 gjuajtës dhe nga ana tjetër thotë  
4 që kishte parë dhe municione dhe armë të tjera.”

5 A ia keni dhënë këtë informacione z. Simic, ia keni dhënë  
6 këtë informacion lidhur me armët z. Simic? Keni qenë ju që ia  
7 keni dhënë informacionin, apo jo?

8 PË. Jo, nuk është e saktë kjo. Unë nuk ia kam thënë fare  
9 Simic këtë informacion.

10 PY. Pra, e gjithë kjo që është në raport, pra të gjitha ato  
11 që ka raportuar Simic, informacionin nuk ia keni dhënë ju  
12 atij, këtë po thoni?

13 PË. Kjo nuk është fare e saktë. Ajo çfarë shkruhet këtu nuk  
14 është fare e saktë. Ajo çfarë ka thënë ose çfarë ka deklaruar  
15 Simic, komandanti, nuk është e saktë.

16 PY. Po në fakt a ka pasë rreth 30 oficerë ose ushtarë policie  
17 aty?

18 PË. Nuk e di, mund të ketë qenë dhe më shumë se sa kaq. Ishte  
19 e pamundur për mua për t'i numëruar.

20 PY. A ka pasur një mijë pjesëtarë me uniforma kamuflazh?

21 PË. Ka pasur shumë ushtarë atje. nuk e di këtë gjë. Sa i  
22 takon numrit, ishte e pamundur për mua për t'i numëruar të  
23 gjithë. Nuk kisha se nga ta dija se sa vetë ishin dhe kush  
24 ishte tjetër aty.

25 PY. Kur ju kanë intervistuar nga shërbimi i sigurimit të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03540 (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 69

1 shtetit më datë 29 shtator, a ju keni dhënë ekzaktësisht të  
2 njëjtin numër rreth 30 oficerë policie dhe 1000 ushtarë? Po  
3 apo jo?

4 PË. Në shtator?

5 PY. Po, në shtator, më 29 shtator.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Besoj që e keni fjalën për  
8 datën 1 tetor.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, e kam fjalën për 29 shtatorin.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

11 Z. KEHOE: [Përkthim]

12 PY. Është e saktë kjo zotëri? A keni dhënë të njëjtat shifra,  
13 pra 30 oficerë policie, dhe 1000 ushtarë të UÇK-së? Janë këto  
14 shifra që keni dhënë?

15 PË. Nuk më kujtohet kjo.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull, le të shohim dokumentin  
17 112054 deri 112058 --

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk më kujtohet kjo.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull, atëherë shikojmë faqen e  
20 parë pastaj shikojmë tek shpjegimet e tjera të dhëna më poshtë.

21 Nëse më lejoni që të qartësoj diçka, të korrigjoj diçka.  
22 Që biseda ka ndodhur më datë 29 ndërkohë që raportimi është  
23 bërë më datën 1.

24 PY. Pra, ky është raporti i datës 1 tetor lidhur me një  
25 bisedë që keni bërë më datë 29 shtator.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Tani le të shohim pak faqen 112057.

2 PY. Në fakt, ju këtë informacion ia keni dhënë autoriteteve  
3 serbe, apo jo? Dëshmitar?

4 PË. Çfarë u kam thënë autoriteteve serbe?

5 PY. Këtë deklaratë në fakt ia keni dhënë autoriteteve serbe,  
6 apo jo?

7 PË. Pyetje, por çfarë informacioni kam dhënë, çfarë kam thënë  
8 aty në deklaratë?

9 PY. E keni deklaratën përpara, zotëri. Deklaratën që keni  
10 dhënë është përpara, në ekran. E keni përpara në ekran.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të shohim pak faqen e parë?

12 PY. Kjo është deklarata kur nuk keni përmendur Latif Gashin  
13 dhe Nuredin Ibishin. A i mbani mend këto pyetje që ju janë  
14 bërë nga ZPS-ja?

15 PË. A mund ta përsërisësh edhe një herë çfarë thatë për ZPS-  
16 në?

17 PY. Ky është dokumenti të cilit e patë dhe ju kërkoi ZPS-ja  
18 ta shikonit këtë dokument. A nuk i thatë ZPS-së që e keni  
19 dhënë këtë deklaratë për autoritetet serbe më datë 29? Datën,  
20 dokumenti e ka më 1 tetor, megjithatë, ju deklaratën e keni  
21 dhënë më datë 29 shtator.

22 PË. Po.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Nëse do të shohim 11287 [sipas  
24 përkthimit].

25 PY. Dhe në qoftë se do të shikojmë këtë dokument, ti thua që:

1 "Me aq sa mund të shikoheshin, ishin rreth 30 oficerë  
2 policie, 1000 ushtarë dhe të gjithë ata qëndronin në një  
3 shkollë në afërsi të Potokut."

4 A jua ke thënë këtë gjë autoriteteve serbe më datë 29  
5 shtator?

6 PË. Po, e kam thënë këtë informacion. Por, në një farë mase  
7 unë po ndihesha pak më mirë, pak i çliruar, kështu që mund të  
8 përqendrohesha më mirë.

9 PY. Pra, ju i keni dhënë autoriteteve serbe të njëjtin numër  
10 oficerësh policie dhe ushtarësh të UÇK-së, 30 dhe 1000, që ka  
11 përmendur gjithashtu edhe Simic në intervistën që ai pretendon  
12 të ketë bërë me ju më datë 29 shtator. Është e saktë kjo?

13 PË. Nuk ia kam thënë Simic këtë gjë. Në qoftë se Simic e ka  
14 marrë këtë informacion, unë nuk e di nga e ka marrë. Këtë e  
15 kam thënë, ndërkohë që sa i takon Simic nuk e di se nga e ka  
16 marrë Simic këtë informacion.

17 PY. A është e drejtë të thuhet që në momentin që ju mundët,  
18 ju dhatë informacion të plotë autoriteteve serbe sa i takon  
19 trupave, sa i takon numrave, sa i takon municionit, armëve dhe  
20 pozicioneve dhe që e ndatë këtë informacion me autoritete  
21 serbe në momentin e parë që patët mundësi ta bënit këtë gjë?

22 PË. Për çfarë kohe e keni fjalën, në çfarë kohe thoni që e  
23 kam thënë këtë? Nuk e kuptova si duhet pyetjen.

24 PY. A është e saktë dëshmitar dhe do ta përsëris sa herë që  
25 të ketë nevojë, në qoftë se nuk më kuptoni, thjesht më thoni.

1 Pyetja është kjo: A është e saktë se menjëherë pas lirimit  
2 tuaj informuat autoritetet serbe për numrin e forcave për  
3 pozicionet mbrojtëse për armët dhe kështu me radhë, dhe ku  
4 ishin të vendosura forcat e UÇK-së, në këtë rast në fshatin  
5 Popov dhe në një shkollë afër Potokut. Ju këtë ia thatë  
6 autoriteteve serbe menjëherë pas lirimit tuaj, a është kjo e  
7 saktë?

8 PË. Jo, atëherë, jo. Kjo është më vonë. Kjo është thënë më  
9 vonë. Por jo në atë kohë, sepse në atë kohë nuk isha në  
10 gjendje të dija ose t'ua jepja atyre këtë informacion.

11 PY. Por ju pajtoheni me mua që deklarata që kemi në ekran dhe  
12 që keni dhënë më datë 29 është në fakt deklarata që ia keni  
13 dhënë autoriteteve serbe më datën 29 shtator, është kjo e  
14 saktë?

15 PË. Po, e kam dhënë atë deklaratë.

16 PY. Tani, kur keni qenë i ndaluar, ju bënë pyetje në qoftë se  
17 keni qenë i përfshirë apo i implikuar me anëtarë të ndryshme  
18 të aparatit shtetëror serb. Dhe e kam fjalën për Mica  
19 Janackovic [sipas përkthimit], Tomislav dhe kështu me radhë. A  
20 është kjo e saktë? Tomislav Petkovic [sipas përkthimit].

21 PË. Jo. Unë nuk kam qenë në kontakt me ta, nuk kam pasë  
22 kontakte me ta gjatë kohës që kam qenë në ndalim me asnjërin  
23 prej tyre.

24 PY. Por ju kanë bërë pyetje në lidhje me këta persona. Ata që  
25 ju kanë marrë në pyetje, ata të UÇK-së që ju kanë marrë në



1 pyetje?

2 PË. Po. Latif Gashi më ka marrë n pyetje dhe më ka pyetë për  
3 Mico Petkovic [sipas përkthimit]. Është një person që ka  
4 punuar në sigurimin shtetëror në Prishtinë. Ai më tha në atë  
5 rast se menjëherë sa t'u jepet rasti, do ta vrasin. Dhe e kanë  
6 vra menjëherë diku në shtator apo në tetor. Ky person është  
7 vrarë në atë kohë.

8 PY. Dhe njëri nga personat që ka qenë i ndaluar bashkë me ju,  
9 ka qenë edhe ky me emrin Sabit Berisha? A është kjo e saktë?

10 PË. Po.

11 PY. Po a ka qenë i ndaluar bashkë me ju edhe dikush me emrin  
12 Sabit Krasniqi?

13 PË. Jo. Ka pasë edhe të tjerë më vonë, mirëpo me mua askush  
14 nuk ka folur dhe nuk ka guxuar të flasë me mua gjatë kohës që  
15 kam qenë në burg.

16 PY. E kam të qartë, por nga ajo që dini ju, Sabit Berisha ka  
17 qenë një informues që ju ka kalu informacion autoriteteve  
18 serbe, a është kjo e saktë?

19 PË. Ashtu thuhej se ishte. E saktë, por a ka qenë ose jo,  
20 këtë nuk e di. Mirëpo atje thuhej që kishte qenë bashkëpunëtor  
21 i autoriteteve serbe. Por unë këtë nuk mund ta konfirmoj në  
22 qoftë se ka qenë ose jo. Sepse atij i është thënë dhe këtë ma  
23 ka thënë edhe Berisha që i kanë gjete një farë dokumentacioni  
24 të disa gjeneralëve nga Beogradi. Tani se çfarë -- kanë  
25 përmbajtur ato dokumente, nuk e di saktësisht.

1 PY. Po, a keni dijëni që ky oficeri Simic e ka quajtur atë  
2 një informator i yni? E kam fjalën për të njëjtin dokument, në  
3 të njëjtën faqe.

4 PË. Këtë nuk e di. Nuk e di.

5 PY. E keni përmendë këtë në lidhje me Sabit Berishën se  
6 Berisha ka pasë dokumente kur i kanë kontrolluar shtëpinë, i  
7 kanë gjetur dokumente në lidhje me gjeneralë serbë të  
8 Beogradit, a është kjo e saktë?

9 PË. Po, ai këtë vetë ma ka thënë.

10 PY. Dhe këta gjeneralë serbë ishin njerëzit me të cilët ai  
11 bashkëpunonte, a është kështu?

12 PË. Nuk e di. Ai tha që i kanë gjetë dokumentet, tani në  
13 qoftë se ka bashkëpunuar me ta ose jo, këtë nuk e di. Por  
14 sigurisht, apo besoj që ka bashkëpunuar meqë e kanë arrestuar.

15 PY. E përmendët edhe një person tjetër, Fadil Suljevic, e  
16 saktë?

17 PË. Po.

18 PY. Na treguat në seancën e mëngjesit, është në faqen 35 të  
19 transkriptit, rreshtat 16 deri në 18:

20 "Tani, në qoftë se Fadili ishte dhe ai i burgosur apo  
21 thjesht e kishin vendosë me ne në dhomë, është diçka që nuk  
22 mund ta konfirmoj."

23 A ju kujtohet kjo deklaratë që bëtë sot në mëngjes?

24 PË. Po.

25 PY. Në fund, Fadil Suljevic u kthye për t'ju takuar mbasi

1 ishte larguar, dhe erdhi me uniformë të UÇK-së? I veshur me  
2 uniformë të UÇK-së?

3 PË. Ai shkoi më datë 27 gusht, kurse në mëngjesin e 28  
4 gushtit erdhi me uniformë, më përshëndeti dhe më tha se do të  
5 më ndihmonte për të më liruar.

6 PY. Dhe ai ishte i veshur me atë që sipas mendimit tuaj ishte  
7 uniformë e UÇK-së?

8 PË. Ai më tha që do të shkonte në UÇK. Ai ma tha këtë, Fadil  
9 Suljevic.

10 PY. Tani, kur ta mendoni, më mirë nuk e dini në qoftë se  
11 Suljevic jua ka treguar të vërtetën apo në qoftë se është  
12 përpjekur që të nxjerrë informacion prej jush. Është kjo e  
13 saktë?

14 PË. Këtë nuk mund ta konfirmoj, nuk e di në qoftë se është e  
15 vërtetë ose jo.

16 PY. Atëherë, të kalojmë tek intervista juaj më datë 29  
17 shtator, dhe kjo mendoj që është në raportin e gushtit, ju  
18 theksoni --

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Ne mund ta vendosim përsëri në ekran  
20 këtë dokument, 112054 deri në faqen 12058, konkretisht faqja  
21 12057.

22 PY. Dhe ju thoni:

23 "Nga ajo që pashë kishte rreth 1000 anëtarë të UÇK-së dhe  
24 30 policë. Ata ishin të veshur me uniforma të tjera, me  
25 uniforma apo këmisha të zeza, ishin të vendosur në një shkollë

1 afër -- në fshatin Popov afër shkollës në Potok. Ushtarët dhe  
2 oficerët mbanin të njëjtën uniformë. Komandantët e tyre nuk  
3 kanë grada, por të gjithë e dinin se kush ishte epror dhe kush  
4 nuk ishte. E di për fakt se njëri nga komandantët ishte nga  
5 Reka [sipas përkthimit]."

6 Pyetja ime është: A ju treguat autoriteteve serbe që ju  
7 çonin për të hapë bunkerë?

8 PË. Jo, unë vetë nuk kam shkuar. Kanë shkuar të tjerët. Unë  
9 dhe Berisha nuk kemi qenë në gjendje për të shkuar dhe për të  
10 hapur bunkerë. Nuk e di se kush ka shkuar për ta bërë këtë  
11 punë.

12 PY. Dhe a ju tregove autoriteteve serbe se në fakt UÇK-ja po  
13 hapte bunkerë?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe në fakt ua tregove edhe vendin ku këto forca të  
16 armatosura ishin të vendosura, apo ndodheshin, e saktë?

17 PË. Po.

18 PY. Kur mbaheshe nga UÇK-ja, u akuzuat për pengimin e  
19 kryengritjes së UÇK-së dhe se jepnit informacione autoriteteve  
20 serbe, a është kjo e saktë?

21 PË. Jo, nuk është e saktë që i kam kaluar informacion  
22 autoriteteve serbe. Unë kam qenë një pylltar i thjeshtë dhe  
23 nuk më kanë interesuar se kush, çka është.

24 PY. Po, a nuk i thatë ZPS-së para disa ditëve se kur të  
25 kërkuan sqarim në lidhje me akuzën e pengimit të kryengritjes

1 së armatosur të shqiptar[ve, ju konfirmuat se ky ishte një  
2 pretendim që u është bërë, por që ishte i gabuar.

3 PË. Është e saktë që më akuzuan që isha spiun, por unë këtë  
4 nuk e kam bërë, nuk kam qenë spiun.

5 PY. Por ia keni kaluar gjithë këtë informacion autoriteteve  
6 serbe në lidhje me numrin e forcave, vendin ku ishin të  
7 vendosura, me pozicionet e mbrojtjesh, dhe ku ishin shtabet. A  
8 është kjo e saktë?

9 PË. Këtë informacion e kam dhënë mbasi u lirova nga ndalimi.

10 PY. Të kalojmë te Osman Sinani. Na treguat se thuhej që ai  
11 bashkëpunonte me serbët. A është kjo e saktë?

12 PË. Ashtu thuhej, por nuk e di në qoftë se ka bashkëpunuar  
13 pse jo. Ai ishte mësues me profesion. Unë atë person e kam  
14 njohur, ka ndejtë nëpër kafene serbe sikurse unë kam ndejtë  
15 nëpër kafene shqiptare. Nuk e di në qoftë se ka bashkëpunu ose  
16 jo me serbët. Unë Osman Sinanin e njoh nga Podujeva ai me  
17 prejardhje është nga fshati Murgull. Prej Barës, ku na  
18 transferuan në Bajgore, mua më vendosën në dhomën ku ishte  
19 Osman Sinani dhe Suljevic.

20 Dhe kur më vendosën në dhomë, pyeti "A je gjallë?" Sepse  
21 ai kishte dëgjuar që më kishin vrarë dhe më kishin hedhur në  
22 pus. E morën Sujlevic dhe pastaj e kthyen përsëri në dhomë  
23 mbas një ore dhe mua më transferuan në një dhomë tjetër ku  
24 ishte Sabit Berisha dhe rreth pesë apo gjashtë persona të  
25 tjerë. Nuk e di se prej nga i kishin sjellë, por ishin edhe

1 ata të burgosur.

2 PY. Në lidhje me Osman Sinanin kur ke shku, që ka shku në  
3 pyll, ti nuk ke pasë informacion në qoftë se e kanë shtënë me  
4 armë kundër tij ose jo.

5 PË. Ka dy versione. Është hapur zjarr. Nuk e kam pa ta kenë  
6 vrarë, por Fadil Sujlevic e konfirmoi këtë më vonë. Disa ditë  
7 më vonë ai ma konfirmoi që këtë person e kishin vrarë, e  
8 kishin vrarë deri në vdekje me shkop. Ishte një livadh dhe aty  
9 kishte pasë një dru, një -- dushk, rreth 500-600 metra më  
10 larg. Aty e kishin lidhur dhe e kishin vrarë.

11 PY. Tani, do t'ju tregoj -- unë po ju them që është kryer  
12 analiza, ekzaminimi mjekoligjor i kufomës së Osman Sinanit dhe  
13 është konstatuar se ai nuk është vrarë nga plumbi. A e dini  
14 këtë gjë?

15 PË. Më falni, a mund ta përsëritni pyetjen?

16 PY. Unë ju sugjeroj se sipas provave të një analize  
17 mjekoligjore që kanë kryer autoritet serbe Osman Sinani nuk  
18 është vrarë nga plagë plumbi. A e dini këtë?

19 PË. Prandaj Fadil Sujlevic më tregoi që e kanë vrarë duke e  
20 rrahur me shkop, domethënë është rrahë deri në vdekje.

21 PY. Ky është i njëjti Fadil për të cilin folët në faqen 35 të  
22 transkriptit të sotshëm, rreshti 16, i njëjti person që thatë  
23 se nuk dinit në qoftë se ishte i burgosur si ju apo ishte  
24 dikush që e kishin sjellë thjesht aty në grupin tuaj për t'ju  
25 hetuar. Është i njëjti Fadil ky?

1 PË. Po, është i njëjti person.

2 PY. A ju kujtohet që i keni thënë ZPS-së se Fadil Suljevic  
3 nuk ju ka treguar se çfarë i kishte ndodhë Osman Sinanit, a ju  
4 kujtohet kjo?

5 PË. Jo.

6 PY. Po ju ndërpres, më falni.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj falje, i nderuar Gjykatës.  
8 Nuk e kisha ndërmend ta ndërpres, por mendoj që përfundoi me  
9 përgjigjen.

10 PY. A kishit diçka për të thënë, dëshmitar?

11 PË. Jo, e përfundova përgjigjen.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Tani të shkojmë tek faqja -- te  
13 dokumenti 070629, në anglisht, Pjesa 1, faqja 21, rreshtat 15  
14 deri 19, dhe versioni në serbisht i njëjti numër ERN, Pjesa 1,  
15 faqja 19, rreshtat 21 deri 25, dhe versioni në shqip, i njëjti  
16 numër ERN, dhe Pjesa 1, faqja 21 rreshtat 19 deri 25.

17 PY. Është pyetje e ZPS-së dhe përgjigje që keni dhënë ju.

18 Përgjigjja:

19 "...fola me Suljevic. Ai më tha që nuk dinte gjë"--

20 Po flasim për Osman Sinanin.

21 "... pra fola me Suljevic, por ai më tha që nuk dinte gjë  
22 dhe pse i dinte të gjitha.

23 "PY. Për Osman Sinanin?

24 "PË. Ai i dinte të gjitha.

25 "PY. A të tregoi se çfarë i kishte ndodhur Osman

1 Sinanit?

2 "PË. Jo, vetëm më tha që ka shkuar.

3 Pyetja ime për ju është, a jua bëri këtë pyetje ZPS-ja  
4 dhe a i dhatë ju këto përgjigje në intervistën tuaj me ZPS-në?

5 PË. Nuk më kujtohet të kem dhënë përgjigje të tilla, apo një  
6 deklaratë të tillë, vetëm e di se Sujlevic, mbas katër-pesë  
7 ditëve, aty në Bajgore më tregoi që Osman Sinani nuk është më  
8 aty. Dhe se sigurisht e kanë vrarë me shkopinj.

9 PY. Deklarata që ia keni dhënë ZPS-së para disa ditëve dhe  
10 deklaratën që dhatë sot se Sinanin e kishin vrarë shkopinj,  
11 bazohet në diçka që ju ka thënë dikush që mund të ketë  
12 informator ose jo.

13 PË. Vetëm Suljevic e ka konfirmuar këtë.

14 PY. Dhe kur thoni që Suljevic ju ka thënë, që dikush i kishte  
15 thënë se ajo kishte ndodhur, ju në fakt nuk e dini në qoftë se  
16 Fadil Sujlevic ua ka tregu të vërtetën, a është kjo e saktë?

17 PË. Prej nga ta di unë? E para, nuk e di në qoftë se dhe ai  
18 ka qenë i burgosur apo e kishin futë në dhomë me ne për të na  
19 marrë në pyetje. Unë kam thënë dhe e di sigurisht që Sujlevic  
20 më ka thënë se këtë person e kishin vrarë me shkopinj.

21 Dhe ai Suljevic ma ka dhënë bluzë të cilën e ruaj edhe  
22 sot e kësaj dite. Kisha ftohtë dhe ai më dha një xhemper, një  
23 bluzë Fadili.

24 PY. Kur u intervistove nga ZPS-ja më datë 14 dhjetor 2019,  
25 dhe besoj që kjo është në intervistat e ZPS-së, kur keni folur



1 për Suljevic, jeni pyetur, "Suljevic a ju tregoi diçka për  
2 Osman Sinanin", dhe ju përgjigjieni:

3 "Jo. Ai vetëm më tha që ky person kishte shkuar".

4 Dhe kjo është përgjigjja juaj në pyetjen që konkretisht  
5 ua bëri ZPS-ja, a e dini në qoftë se Sujlevic jua ka treguar  
6 këtë gjë ose jo? Dhe ju e keni dhënë atë përgjigje. A ua bëri  
7 këtë pyetje ZPS-ja, dhe a e dhatë ju atë përgjigje në atë  
8 intervistë?

9 PË. Unë e di që ai më tha që Sinanin e kishin vrarë me  
10 shkopinj. Mund t'ju them që deklaratat nga 2009 nuk ekzistojnë  
11 më. Përnjëherë humbën të gjitha ato transkripte të gjykimit,  
12 procesverbalet. Domethënë dokumentacioni nga ato gjykime të  
13 mëparshme nuk ekzistojnë më. Thjesht është humbur -- është  
14 zhdukë i gjithë dokumentacioni. Dhe mund t'ju them që edhe  
15 përkthyesve nuk ju zija besë, nuk ju besoja.

16 PY. Unë ju them se deklarata që u lexova se a e keni ditë  
17 nëse Sujlevic ju ka treguar se çfarë ka ndodhur me Osman  
18 Sinanin, dhe ju jeni përgjigjur me "jo". Kjo është një  
19 deklaratë që ju e keni dhënë në vitin 2019, jo në vitin 2009,  
20 dhe atë deklaratë apo atë intervistë ia keni dhënë ZPS-së,  
21 Zyrës së Prokurorit të Specializuar, dhe unë lexova fragment  
22 nga ajo intervistë se kjo është një deklaratë që nuk ia keni  
23 dhënë UNMIK-ut apo EULEX-it. Është një deklaratë që ia keni  
24 dhënë ZPS-së në vitin 2019.

25 Tani, kjo deklaratë që ia keni dhënë ZPS-së nuk flet

Dëshmitari: W03540 (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 82

1 aspak për atë në qoftë se ky person është rrahur me shkopinj  
2 ose jo. A është kështu?

3 PË. Jo, kjo mua nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet, për 2019.

4 PY. Unë ju them që prova që ka dëgjuar Trupi Gjykues, sipas  
5 tyre Osman Sinani është vrarë nga një bombardim i kryer nga  
6 serbët në Bajgore në shtator të vitit 1998. E dini këtë?

7 PË. Jo.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të kalojmë në seancë private?

9 Se dua që t'i referohem deklaratës së një dëshmitari që ka  
10 dëshmuar në seancë private.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në  
12 seancë private, ju lutem.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W03540 (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Page 83

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

4 Z. KEHOE: [Përkthim]

5 PY. Pra ju po na thoni që nuk ka pasur granatime nga forcat  
6 serbe në Bajgore në shtator 1998? Këtë po thoni në dëshminë  
7 tuaj?

8 PË. Jo, nuk e di. S'e di çfarë bënë autoritetet serbe. Nuk e  
9 di a bënë granatime, jo. Unë di që kishte luftime në 1999.  
10 Nuk e kuptoj dot si mund të kenë bërë autoritetet serbe  
11 granatime në 1998.

12 PY. Atëherë, fokusohemi në provën materiale P00167.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Le ta vendosim në ekran.

14 PY. Ky është dokumenti për të cilin diskutuat me Prokurorinë  
15 dhe që jua tregoi Latif Gashi, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe më duket se na the se mësuat gjatë bisedave të  
18 ndryshme me persona të ndryshëm gjatë kohës që ishit në  
19 ndalim, pra mësuat që Latif Gashi ishte kryesori i UÇK-së,  
20 kështu? Po përdor fjalën që keni përdorur ju.

21 PË. E drejtë.

22 PY. Dhe ju mësuat se Latif Gashi, sipas jush kjo, ishte  
23 personi kryesor që organizonte keqtrajtimet dhe marrjen në  
24 pyetje, kështu?

25 PË. E drejtë.

1 PY. Në fakt, edhe juve ju mori vetë në pyetje Latif Gashi,  
2 kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Ju mori në pyetje Latif Gashi në disa vende, kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Edhe, kur ju treguam të gjitha fotografitë, ju e  
7 identifikuat fotografinë e Latif Gashi, atë zgjodhët, kështu?

8 PË. Po.

9 PY. Edhe ai ju dha edhe letrën e lirimit dhe kushtet për  
10 lirim tuaj, kështu?

11 PË. Po, kështu është.

12 PY. Dhe ju dhatë dëshmi lidhur me të gjitha informatat sa i  
13 takon Latif Gashit, tre herë keni dhënë dëshmi si para  
14 gjykatës së UNMIK-ut, Gjykatës Themelore të Prishtinës,  
15 kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Latif Gashi u dënua, apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. U dënua me burgim, apo jo?

20 PË. Po.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Një moment, i nderuar Gjykatës, sa  
22 të konsultohem me kolegët.

23 Nuk kam më pyetje.

24 PY. Faleminderit z. Dëshmitar.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Strong.

1 Z. STRONG: [Përkthim] Nuk kemi pyetje për këtë dëshmitar.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi pyetje për këtë

4 dëshmitar.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Kemi pyetje, më jepni vetëm një

7 minutë sa të përgatitem.

8 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

9 Z. ELLIS: [Përkthim]

10 PË. Dëshmitar, në fillim do t'ju tregoj provën materiale 194

11 në faqen 74, të provës materiale të cilën përmenda. Besoj se

12 ka numrin e referencës ERN SPOE00209239.

13 Besoj se është e drejtë të themi që në shkurt të vitit

14 2000 ju kanë trajtuar për depresion, kështu? Jeni kuruar për

15 depresion.

16 PË. Kështu është.

17 PY. Nëse lexojmë paragrafin e parë të këtij paragrafi thuhet

18 që jeni:

19 "Pranuar në pavijonin neuropsikiatrik për shkak se është

20 përkeqësuar gjendja juaj", të shqetësuar, kishit probleme me

21 humorin, kishit humbur memorien, kishit shqetësime, kishit

22 disa probleme të ndryshme, humbët oreksin.

23 I shihni këto shënime këtu?

24 PË. Po, i shoh.

25 PY. Pra, para shkurtit 2000, ju kishit filluar të kishit

1 problem përfshirë këtu edhe humbjen e kujtesës, por që u bënë  
2 më keq me kalimin e kohës derisa mbërritët në momentin që  
3 flitet në këtë raport, kështu?

4 PË. Po.

5 PY. Është kjo një nga simptomat psikologjike që ju thoni se  
6 vazhdojnë sot e kësaj dite?

7 PË. Po.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë mund të vendosim edhe një  
9 herë në ekran materialin me numër U002-3926. Dhe anglishtja  
10 është U002-3926-ET.

11 PY. Ky është një dokument që ka shkruajtur z. Simic, jua  
12 tregoi edhe z. Kehoe një çast më përpara. Ju vazhdoni të thoni  
13 që s'i keni dhënë deklaratë z. Simic? Më duket se ia thatë  
14 Prokurorisë sot paradite që gjysmë minute keni folur me atë.

15 PË. Nuk e kam dhënë asnjë deklaratë, dhe them që i kam folur  
16 mbase për një minutë. I qëndroj kësaj, nuk i kam dhënë asnjë  
17 deklaratë z. Simic.

18 PY. Mirë, e shohim bashkë. Paragrafi i dytë që fillon "më  
19 datën 2 gusht 1998..." E shihni? A është e vërtetë që ju kanë  
20 ndaluar më 2 gusht 1998 afër një vendi që quhej Dobra Voda?

21 PË. Po. Mbase 500 metra larg nga Dobra Voda, diku në pyll,  
22 aty më morën si të burgosur. Dobra Voda, aty më arrestuan e  
23 kam llafin.

24 PY. Në qoftë se shkojmë te paragrafi tjetër, në qoftë se  
25 kalojmë te paragrafi tjetër, është e drejtë të themi që ju

1 bënë pyetje për individë të ndryshëm përfshirë Tomislav

2 Petrovic dhe Mica Jovic, kështu?

3 Pra këta dy personat, ju thatë më bënë pyetje për këta  
4 persona gjatë kohës që ishit i burgosur, i ndaluar.

5 PË. Po. Mica Jovic punonte -- për sigurimin e shtetit ndërsa  
6 Tomislav punonte për policinë.

7 PY. Informacioni që i ke dhënë z. Simic më 26 shtator 1998,  
8 ia keni dhënë pra ju këtë informacion?

9 PË. Jo, nuk ia kam dhënë. S'kam pasë ndonjë kontakt me Simic.

10 PY. Se e kam të vështirë ta kuptoj tani nga e ka marrë  
11 informacionin, sepse juve ju kanë bërë pyetje për këta dy  
12 persona, nga e ka marrë kur s'e ka marrë nga ju këtë  
13 informacion?

14 PË. Nuk e di. Nuk e di nga e ka marrë këtë informacion.  
15 Vërtet nuk e di.

16 PY. Kam dhe dy pyetje për Sabit Berishën. Ai ishte një person  
17 që ju thatë që dikur ka qenë mësues, kështu?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe ju mendoni se ishte nga fshati -- ju kërkoj ndjesë --  
20 Konjusevac?

21 PË. Konjushevci, po.

22 PY. Kalojmë në faqen e dytë të këtij dokumenti. Paragrafi i  
23 dytë, ku thuhet "Pas ca kohe..." lexojeni vetë pa zë, dhe na  
24 thoni kur të mbaroni.

25 PË. Nuk e di çfarë prisni prej meje. Çfarë përgjigje duhet të



1 jap unë?

2 PY. Është e vërtetë që ka ndodhur një incident kur keni qenë  
3 në fshatin Majac? Ku një helikopter goditi ndërtesën ku po  
4 qëndronit ju? Ju po qëndronit përballë kësaj ndërtese pra, a  
5 është e vërtetë -- që një helikopter goditi, edhe  
6 raketahedhëse?

7 PË. Po.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe paragrafi i fundit po në të  
9 njëjtën faqe.

10 PY. Përmendet Fadil Suljevic dhe thotë që ka dhënë një  
11 xhemper të thurur. Është e vërtetë që ta ka dhënë Fadil  
12 Suljevic një xhemper?

13 PË. Po, po. Akoma e kam edhe sot e kësaj dite.

14 PY. Pra, të gjitha këto hollësitë që ka ky dokument, duke i  
15 parë të gjitha këto, ju vazhdoni të thoni që ju nuk i keni  
16 dhënë deklaratë z. Simic, kur ju liruan? Edhe pse i shihni të  
17 gjitha këto hollësi në këtë dokument?

18 PË. Edhe tani them të njëjtën gjë, i qëndroj kësaj.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkojmë në faqen e fundit të  
20 dokumentit që mban numrin U002-3928.

21 PY. Thuhet:

22 "Gjatë intervistës", s'po e lexoj emrin, "ndonjëherë  
23 emocionohej shumë, i lotonin sytë, qante. Ishte i lodhur, i  
24 sfilitur, por edhe shumë i lodhur shpirtërisht..."

25 Ishit ju në vete, ishit në gjendje të mirë kur folët me

1 z. Simic në 26 shtator 1998?

2 PË. Nuk kam folur fare me Simic. Nuk është e drejtë, nuk kam  
3 folur.

4 PY. Kemi pasur edhe disa dokumente që në fakt i dhatë ju të  
5 premtën kur takuat Prokurorinë. Ishte një akt-ekspertizë aty,  
6 e forenzikës, dhe ju thatë kjo ishte për gjykatën në Nish. Ju  
7 kujtohet ky dokumenti? Po pohoni me kokë, domethënë "po"?

8 PË. Po, ishte një aktekspertizë forenzike nga Nishi.

9 PY. Për cilin proces gjyqësor u përgatit ky dokument?

10 PË. Gjykata e Prokupjes e kishte kërkuar këtë dokument,  
11 deshën të dinin nëse kisha ende probleme shëndetësore apo isha  
12 më mirë nga pikëpamja shëndetësore.

13 PY. Po për cilin proces gjyqësor ju duhej ky raport?

14 PË. Ishte -- një kompani serbe dhe kosovare në gjyq me njëra-  
15 tjetrën dhe kërkoi avokati që të merrja kompensim, prandaj dhe  
16 -- u kërkua aktekspertiza e forenzikës.

17 PY. Ky është i vetmi rast kur keni kërkuar kompensim sa i  
18 takon incidenteve ku përfshihej edhe Serbia?

19 PË. E ke fjalën për aktekspertizën forenzike?

20 PY. Dua të them a ke kërkuar ndonjëherë tjetër kompensim në  
21 Serbi lidhur me ngjarjet e gushtit dhe shtatorit 1998?

22 PË. Jo, në 1998? Kosova ishte akoma pjesë e Serbisë dhe  
23 Srbijasume ishte përgjegjëse, ishte në juridiksionin e tyre. A  
24 more kompensim në përfundim të këtij procesi gjyqësor që sapo  
25 përshkruam?

Dëshmitari: W03540 (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 91

1 PY. Po, pak.

2 PË. Sa more?

3 PY. 200.000.

4 PË. 200.000 çfarë?

5 PY. Dinarë.

6 PË. Kur i more, këtë kompensim?

7 PY. Nuk e di. Dikur rreth vitit 2004, 2005. Pak a shumë në  
8 këtë periudhë. Nuk jam shumë i sigurt për datat.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Pyetja e fundit në fakt është edhe  
10 identifikuese, kështu që do t'ju lutesha të kalonim në seancë  
11 private.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

13 [Nuk ka përkthim]

14 [Seancë private]

15 [Seancë private teksti i fshirë]

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ritakohemi

17 këtu në orën 14.30.

18 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.51

19 --- Seanca rifillon në orën 14.30

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni ju

21 lutem.

22 Përpara sesa të vazhdojmë me seancën e pasdites, kam një

23 urdhër gojor të vogël, lidhur me një çështje procedurale.

24 Udhëzoj ZPS-në t'i janë Trupit Gjykues, palëve dhe

1 pjesëmarrësve listën e 12 dëshmitarëve nga lista e 40  
2 dëshmitarëve dhe ta dorëzojë këtë deri të premtën, me datë 30  
3 qershor, 2023, në orën 16.00.

4 Përveç listës së 12 dëshmitarëve të planifikuar, ZPS-ja  
5 duhet gjithashtu të japë një listë të 5 dëshmitarëve që do të  
6 jenë në pritje përveç 12 dëshmitarëve të parashikuar.

7 Lista duhet të jetë në përputhje të plotë me paragrafin  
8 74 të Urdhrit për Zhvillimin e Procedurave.

9 Deri të premtën, më datë 7 korrik të vitit 2023, Mbrojtja  
10 dhe ekipet e Mbrojtjes dhe Mbrojtësi i Viktimave, duhet që të  
11 japin një informacion, siç kërkohet në paragrafin 76 të  
12 Urdhrit për Zhvillimin e Procedurave.

13 Kemi disa pyetje nga gjyqtarët. Do të fillojmë me  
14 gjyqtarin Gaynor.

15 Së pari, Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në  
16 sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jeni gati,  
19 Dëshmitar?

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
22 Gjykatësit kanë disa pyetje për ju. Do të fillojmë me  
23 gjykatësin Gaynor.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi  
25 Smith.

1 Pyetje nga Trupi Gjykses:

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim]

3 PY. Mirëdita, dëshmitar.

4 PË. Mirëdita.

5 PY. Dëshmitar, sa e kuptoni gjuhën shqipe?

6 PË. E kam ditur pak para shumë kohësh, por tani e kam harruar  
7 pjesën më të madhe. Kanë kaluar më shumë se sa 25 vjet që e  
8 kam folur këtë gjuhë. Mund të flas pak. Më përpara kam folur  
9 pak por tani mezi flas.

10 PY. Kur bisedoi me ju Latif Gashi, ai përdori serbishten si  
11 gjuhë?

12 PË. Po, vetëm serbisht.

13 PY. Kur Latif Gashi fliste me të tjerët në gjuhën shqipe, a  
14 kishe mundësi që ta ndiqje bisedën që ai bënte me ta? Në  
15 përgjithësi, flas.

16 PË. Nuk e ndiqja plotësisht, ndiqja tek tuk, diku. Në qoftë se  
17 do të duhej që të bëja diçka, domethënë, për gjërat që duhej  
18 të bëheshin, mbase, por për tjetër gjë jo.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ndërkohë që keni qenë të  
20 mbajtur në -- të ndalur në Bare dhe në Bajgorë, a kishit  
21 mundësinë që të bënit dallimin ndërmjet ushtarëve dhe atyre që  
22 ishin me policinë ushtarake?

23 PË. Po, policia kishte uniforma të zeza, ndërsa ushtria  
24 kishte uniforma kamuflazh. Ngjyrë jeshile.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A ishit në gjendje që të

1 mësonit se kush kishte qasje në pikën e ndalimit në Bar dhe në  
2 Bajgore? Domethënë, a ishin ushtarët apo ishte policia  
3 ushtarake që kishte qasje në këto godina?

4 PË. Policia ushtarake. Policia ushtarake na ruante ne.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani dua që t'i kthehem dy  
6 incidenteve të shtimeve -- me shtirje. Domethënë, së pari  
7 ishte gjuajtje që përfshinte Osman Sinanin dhe së dyti  
8 gjuajtjet që kishin të bënin me tre shqiptarët. Tre burrat  
9 shqiptarë.

10 Sa i takon incidentit, ose rastit të parë, sot në qoftë  
11 se do të shkojmë do shohim faqen 26, thua, dhe këtu citoj:

12 "Kur Sinanin dhe mua më morën në pyll për të ekzekutuar,  
13 Sinanin e lidhën me duar pas në një peme ndërsa mua më lidhën  
14 në një pemë tjetër dhe unë i dëgjova kur ata i thanë: "A do të  
15 pranosh që ke bashkëpunuar me serbët?" Ai tha "Jo, nuk kam  
16 bashkëpunuar asnjëherë me serbët."

17 Ky është fundi i citimit. Personat që ju dërguan në pyll,  
18 çfarë ishin, ushtarë apo ishin persona që punonin për policinë  
19 ushtarake:

20 PË. Ushtarë.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në çfarë gjuhe folën ata me  
22 Sinanin?

23 PË. Kryesisht ishte në serbisht, në mënyrë të tillë që të më  
24 frikësonin mua që të më shtrëngonin ose të më detyronin që të  
25 pranoja. Ata kryesisht kanë folur serbisht.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kur kanë folur me Sinanin,  
2 kur i janë drejtuar Sinanit ata, çfarë gjuhe përdorën?

3 PË. Kryesisht serbisht. Në mënyrë të tillë që edhe unë të  
4 dëgjoja se çfarë po thoshin ata dhe të frikësohesha, ndërkohë  
5 që ata po e kërcënonin atë se do ta vrisnin. Kështu që  
6 kryesisht kanë folur serbisht. Në mënyrë të tillë që të më  
7 frikësonin mua dhe që të pranoja që kisha qenë agjent.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa të shtëna dëgjuat?

9 PË. Një.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kur ua hoqën këtë gjënë që  
11 ju kishin mbuluar sytë, ishte ditë apo ishte natë? Këtë  
12 lidhësen e syve kur ua hoqën, ishte ditë apo ishte natë?

13 PË. Ishte natë.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa larg ishte pema ku ishte  
15 lidhur Sinani në krahasim me pemën ku ishte lidhur ti? Sa larg  
16 ishte nga pema jote ku ishte lidhur Sinani?

17 PË. Mbase një metër, përfaqësisht një metër.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju thatë më herët që të  
19 shtënat në drejtim të Sinanit mund të kenë qenë të shtëna të  
20 rreme. A jeni në dijeni të ekzekutimeve të tjera të krimeve të  
21 rreme, të kryera nga UÇK-ja?

22 PË. Nuk di gjë rreth kësaj, nuk e di në qoftë se kanë bërë të  
23 njëjtën gjë edhe me persona të tjerë.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sot na thatë se Sulejviçi ju  
25 ka thënë se Sinani dhe citoj "Duhet të jetë rrahur me shkopinj



1 deri në vdekje". A e mbani mend këtë gjë?

2 PË. Po, po, sigurisht e mbaj mend.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A ju tha Sulejviçi që ai ka  
4 qenë i pranishëm kur është rrahur për vdekje Sinani?

5 PË. Jo, jo. Nuk më tha asgjë lidhur me këtë. Thjesht më tha  
6 që ai e di që Sinanin e kishin rrahur për vdekje me shkopinj.  
7 Këtë ma tha Sulejviçi.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sulejviçi a ua tha se nga e  
9 dinte ai që e kishin rrahur për vdekje Sinanin?

10 PË. Unë nuk e pyeta rreth kësaj gjëja, nuk guxoja ta bëja një  
11 pyetje të tillë sepse nuk e dija në qoftë se ai ishte i  
12 ndaluar apo në qoftë se ishte i infiltruar në mënyrë të tillë  
13 që të mund të merrte, apo të mblidhte informacione për ne,  
14 kështu që nuk e di.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A është përfundimi juaj se  
16 Sinanin e kanë rrahur për vdekje, e kanë rrahur deri në  
17 vdekje, apo në qoftë se e kanë qëlluar me armë?

18 PË. Përfundimi im vetjak është se atë e kanë rrahur deri në  
19 vdekje sepse kam folur edhe me vëllain e tij pas luftës.  
20 Trupin e tij, ose vëllai e mori trupin në mënyrë që të mund ta  
21 varroste. Nuk e di në qoftë se e kuptuat se çfarë thashë në  
22 përgjigje të kësaj pyetje.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po e kuptoj çfarë po thoni.  
24 Atëherë, sipas jush, sipas mendimit tuaj, Sinani po vepronte  
25 kur atë e kishin të kapur ose po lëvizte le të themi, kur e

1 kishin të lidhur në pemë, ndërkohë që ju dëgjuat që u bë kjo e  
2 shtënë me rreme?

3 PË. Diçka e ngjashme.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Vazhdojmë te diçka tjetër.

5 PË. Ose ndoshta e kanë bërë këtë gjë në mënyrë që të më  
6 frikësonin mua.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani dua të kaloj pak te të  
8 qëlluarit, goditja e tre shqiptarëve.

9 Së pari, a mund të na e sqaroni se nga e dinit ju se këta  
10 të tre persona, a këta tre burra, ishin shqiptarë?

11 PË. Nuk kishte serbë të tjerë, unë isha i vetmi serb aty.  
12 isha i vetmi serb që ishte i ndaluar. Të gjithë personat e  
13 tjerë ishin shqiptarë.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nga e dinit ju se ata ishin  
15 të ndaluar?

16 PË. Kam dëgjuar histori nga të ndaluar të tjerë, që ata ishin  
17 miq të tyre, ishin shokë me ta.

18 PËRKTHYESJA: Përkthyesja kërkon që të bëjë edhe një herë,  
19 pra ta thotë edhe një herë përgjigjen.

20 PË. Pra e thashë edhe më përpara që unë isha i vetmi serb, të  
21 gjithë të tjerët ishin shqiptarë.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund ta përsërisni edhe  
23 një herë atë çfarë po thoshit në lidhje me të ndaluarit, që i  
24 keni dëgjuar histori nga të ndaluarit e tjerë, me të cilët ata  
25 ishin miq? Kishit për të thënë ndonjë gjë tjetër, sepse

1 përkthyesja nuk e kuptoi?

2 PË. Jo, asgjë, në fakt. Thjesht po prisja për momentin kur do  
3 të më vrisnin edhe mua. Nuk thashë asgjë tjetër, nuk guxoja të  
4 thosha asgjë tjetër. T'i thosha askujt asgjë tjetër, sepse ti  
5 nuk lejohej që të flasësh. Domethënë, duhej që të rrish pa  
6 folur.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Këta të tre shqiptarët që  
8 përmende, këta i kishin lidhur në të njëjtën pemë apo i kishin  
9 lidhur në pemë të ndryshme?

10 PË. Jo, jo. Ata i kishin lidhur secilin prej tyre veçmas.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në kohën kur ndodhi ky rast,  
12 ky incident, edhe ju vetë ishin lidhur në një pemë?

13 PË. Po. Jo, ju kërkoh ndjesë. Mua sapo më dërguan atje. Mua  
14 më lidhën dhe ata shtinë edhe tre herë të tjera. Nuk e di në  
15 qoftë se kanë shtënë në drejtim të tyre apo jo sepse sikurse e  
16 thashë, unë i kisha sytë e lidhur. Megjithatë, kur shkuan  
17 atje, ata ishin lënë aty.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Këtë e kuptuat vetëm pasi u  
19 hoqën lidhësen e syve, apo jo?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Këta persona që kishin  
22 veshur ballakllavë, këta çfarë ishin? Ishin ushtarë, apo ishin  
23 pjesëtarë të policisë ushtarake?

24 PË. Ushtarë. Policia vetëm thjesht sa na ruante aty ku ishim,  
25 ku qëndronim në atë kamp ose në atë vend ku na mbanin të

1 ndaluar. Policia na mbante nën ruajtje, ndërkohë që për  
2 ndryshe ushtria është marrë me ne.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kur ju hoqën lidhësen e  
4 syve, a mund të shikonit se cilin prej këtyre tre burrave  
5 shqiptarë që përmendët?

6 PË. Mund të shihja por nuk ishte shumë e -- nuk mund të  
7 shihej shumë qartë sepse kishte një lloj veshje ose,  
8 domethënë, në një farë mënyre më thanë që "shiko, serb, kështu  
9 do të përfundosh edhe ti" domethënë. Unë thjesht sa pashë dhe  
10 pastaj m'i lidhën përsëri sytë.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A patë ndonjë shenjë  
12 lëvizjeje nga ata të tre trupat?

13 PË. Jo.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] E kuptoj edhe nga deklaratata  
15 juaj se Sulejviçi ju tha se këta burra nuk është se janë  
16 qëlluar dhe nuk kanë vdekur për shkak të gjuajtjes me armë,  
17 por që janë rrahur deri në vdekje. A është e saktë kjo?

18 PË. Nuk di për këtë. Po, është e vërtetë që Sulejviçi tha  
19 këtë por unë personalisht nuk e di në qoftë se i kanë qëlluar  
20 dhe i kanë vrarë apo në qoftë se i kanë rrahur deri në atë  
21 pikë sa që kanë vdekur. Nuk mund të konfirmoj dot asgjë lidhur  
22 me ta. Mund të them që u shti tre herë, dhe nuk di në qoftë se  
23 ata janë vrarë në këtë mënyrë apo janë vrarë nga e rrahura.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju thatë në deklaratën tuaj  
25 që arma e përdorur ishte armë automatike, kështu?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po të shtënat në ajër, ishin  
3 sikur të ishin të shtëna nga armë automatike apo ishin të  
4 shtëna të izoluara të vetme?

5 PË. Jo, njëra pas tjetrës ishin të shtënat. Pra e shtëna e  
6 parë, e dyta, e treta.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sulejviçi a tha gjë që ai  
8 vetë i kishte parë këta të tre burra që të ishin rrahur deri  
9 në vdekje?

10 PË. Jo. Jo. As nuk e pyeta fare, nuk e pyeta lidhur me këtë.  
11 Ai nuk më tha gjë. Ju thashë një herë që mua nuk më lejohej që  
12 të flisja me dikë, me përjashtim të rasteve kur më drejtohej  
13 dikush. Domethënë, flisja vetëm kur më drejtohej dikush. Në të  
14 kundërtën, nuk flisja fare, sepse sikurse dhe e përmenda edhe  
15 për Sulejviçin, nuk kisha i sigurt në qoftë se ata ishin të  
16 ndaluar apo në qoftë se ishin për ta marrë në pyetje, për të  
17 mbledhur informacione nga ne. Kështu që nuk flisnim dot.

18 Burrat e tjerë ishin pak më të rinj. Ata nuk flisnin  
19 serbisht, unë nuk flisja shqip, kështu që këtë bënim.  
20 Domethënë, nuk flisnim më.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera. Ju  
22 faleminderit, Dëshmitar.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi  
24 Smith.

25 Dëshmitar, sot paradite u pyetët lidhur me një incident,

1 ku u tha që u dërguat në gjykatë ushtarake dhe ishte një  
2 person i cili tha që ishte gjykatësi i gjykatës.

3 A ju mbahet mend kjo pjesë e diskutuar gjatë ditë së  
4 sotme?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Na treguat që nuk mbanit  
7 mend datën saktësisht kur ka ndodhur incidenti. Kjo është e  
8 kuptueshme. Megjithatë, a jeni në gjendje të na thoni se sa  
9 afërsisht ka qenë me kohën e lirimit tuaj? Domethënë, ka qenë  
10 shumë më përpara ditës kur jeni liruar, më datë 26 shtator? Ka  
11 qenë shumë afër 26 shtatorit? A mundeni të na e shpjegoni se  
12 kur ka qenë përafërsisht?

13 PË. Po, munde. Ndoshta kjo ka ndodhur një mu përpara se sa  
14 të lirohesh.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përveç individit që ju  
16 thatë që ishte gjykatësi, a kujtoni ndokënd tjetër që të ketë  
17 qenë i pranishëm në atë proces?

18 PË. Jo, vetëm një person ishte aty i ulur.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Latif Gashi, a ishte i  
20 përfshirë në atë proces, domethënë a ju çoi deri atje? Ju mori  
21 që aty? A mund të na thoni në qoftë se ka pasur ndonjë  
22 pjesëmarrje Latif Gashi?

23 PË. Jo. Ai duhet ta ketë urdhëruar por nuk ka qenë i  
24 pranishëm. Mua atje më dërguan ushtarët. Ai nuk ishte i  
25 pranishëm. Por është bërë sipas urdhrave të tij, sepse ai i ka

1 nxjerrë të gjithë urdhrat dhe ushtarët duhej që të respektonin  
2 urdhrat e tij.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju iu përgjigjët  
4 gjithashtu një pyetjeje që tregoi që juve ju dërguan në pyll  
5 me Osman Sinanin. Kjo pyetje ju është bërë si nga Prokuroria  
6 ashtu edhe nga Gjykatësi Gaynor. Me sa dini ju, z. Sinani, e  
7 kanë kthyer ndonjëherë mbrapsht te vendi ku mbaheshit të  
8 ndaluar, pas incidentit që ndodhi në pyll? Domethënë, me fjalë  
9 të tjera, pas kësaj here a e ke parë ndonjëherë ti më z.  
10 Sinani?

11 PË. Jo, jo. Nuk e kam parë. Ai ishte me Sulejviçin. Ai dhe  
12 Sulejviçi ishin në të njëjtën dhomë. Ai nuk u kthye asnjëherë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të nxjerrë në ekran  
14 sekretaria dokumentin SPOE0006813.

15 Zotëri, do t'ju tregoj një dëshmi që keni dhënë ju me  
16 datë 21 mars të vitit 2011. Do ju kërkoja që të  
17 përqendroheshit te pyetja në mes të dokumentit. Juve ju bëhet  
18 kjo pyetje:

19 "A dëshironi të na tregoni ndonjë gjë në lidhje me rastet  
20 e tjera?"

21 Dhe në përgjigje ju keni dhënë vullnetarisht këtë  
22 informacion:

23 "...Osman Sinani, mësuesi nga Podujeva u vra me një  
24 shufër."

25 Pra dua t'ju kërkoj, dua t'ju pyes, ky informacion që

1 është dhënë në mars të vitit 2011, sa i takon mënyrës se ishte  
2 vrrarë z. Sinani. Nga e kishe marrë ti këtë informacion që dhe  
3 në vitin 2011? Ishte informacion që kishe marrë nga Sulejviçi  
4 më përpara apo e kishe marrë nga dikush tjetër këtë  
5 informacion?

6 PË. Jo, e kisha mësuar nga Fadil Sulejviçi.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Le të shohim një tjetër  
8 dokument që është dokumenti DHT0978. Është dokument që është  
9 parashtruar nga Mbrojtja e z. Thaçi. Do i kërkoj Sekretares që  
10 përbri këtij dokumenti të vendosë një tjetër dokument me ERN  
11 U00-1634-U008-1634-ET. Është i njëjti dokument si dhe  
12 përkthimi në anglisht. Është dhënë nga palët.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, gjykatës. Thjeshtë  
14 për të thënë që kundërshtojmë si më herët.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

16 Zotëri, kjo duket se është një njoftim për shtyp që ka të  
17 bëjë me përfaqësuesit e përgjithshëm politikë të UÇK-së. Nuk e  
18 di në qoftë se mund të na tregojë Sekretarja fillimin e faqes,  
19 pra data është 10 qershor, 1998. Megjithatë, në qoftë se do të  
20 kalojnë në fund fare të versionit në shqip të këtij njoftimi  
21 për shtyp, është 6 tetor 1998.

22 Pyetja e parë që kam për ju është kjo: A jeni në dijeni  
23 të faktit se pas lirimit tuaj dhe pas vendimit që ju jep juve  
24 Latif Gashi, botohet rasti juaj në mediat e Kosovës. A jeni në  
25 dijeni të kësaj gjëje?



1 PË. Po, po. E di që është botuar në mediat e Kosovës ky  
2 informacion.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur e ke mësuar këtë gjë,  
4 zotëri? Gjatë luftës? Pas luftës? Kur?

5 PË. Pas luftës. Disa kolegë që punonin me mua, kolegë  
6 shqiptarë, pra, erdhën për të më vizituar për të parë sesi  
7 isha dhe ata ma thanë.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju lutem shikoni  
9 paragrafin e dytë të këtij dokumenti. Është paragrafi që  
10 fillon me emrin tuaj dhe me datën e lindjes. Në qoftë se është  
11 shumë e vogël dhe nuk e lexoni dot, mund tua lexoj unë në  
12 mënyrë që ta kuptoni. Por thuhet, siç thuhet në vendimin e  
13 lirimit, u munduat të rezistonit duke nxjerrë revolveri tuaj,  
14 dhe duke ia drejtuar në drejtim të rojeve.

15 A është e vërtetë kjo, zotëri? Pra kur je arrestuar, a e  
16 ke bërë këtë gjë?

17 PË. Jo, nuk është e vërtetë. Nuk kisha mundësi ta bëja këtë  
18 gjë. Ishte çështje sekondash, çastesh. Ata ishin katër, unë  
19 isha vetëm dhe nuk kisha mundësi ta bëja një gjë të tillë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani le të kalojmë te  
21 paragrafi i katërt. Në versionin në anglisht fillon me fjalën  
22 "It is worth mentioning...". Atëherë në fillim, në këtë  
23 paragraf, thuhet që jeni liruar dhe ishit në gjendje  
24 shëndetësore shumë të mirë për t'u kthyer në shtëpi. A ishte e  
25 vërtetë kjo zotëri?

1 PË. Jo, jo, nuk është e vërtetë. Unë arrita në urën e  
2 Llozhanit dhe rashë. Nuk mund të vazhdoja më tej rrugën.  
3 Thjesht më kujtohet se kur shoferi i autobusit doli, pra  
4 shoferi doli nga autobusi, më ndihmoi për të hipur përsëri në  
5 autobus dhe më dërgoi në rajonin e policisë. Kjo është e  
6 gjitha që mbaj mend nga ai rast. Nuk mbaj mend asgjë tjetër.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ka një tjetër pohim të  
8 fundit në këtë dokument për të cilin do të doja t'ju pyesja.  
9 është në të njëjtin paragraf. Është në fillim të paragrafit.  
10 Thuhet se "ja vlen që të përmendet që gjatë kohës kur keni  
11 qenë i ndaluar, forcat e pozicionet e UÇK-së ishin objektivat  
12 e një operacioni të gjerë dhe të rëndë nga forcat e ushtrisë  
13 serbe, së policisë ushtarake serbe."

14 Pyetja për u është kjo: Ndërkohë që ju ishit i ndaluar në  
15 Bajgorë, a keni dëgjuar predha të gjuheshin te vendi ku  
16 mbaheshe ti i ndaluar?

17 PË. Jo, jo.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a keni dëgjuar ndokënd  
19 tjetër aty në atë vend ku keni qenë i ndaluar, a keni dëgjuar  
20 ndonjë person që ishte plagosur apo vrarë nga ndonjë predhë? E  
21 kam fjalën këtu për ndonjë të ndaluar, apo ndonjë roje?  
22 Ushtar? Keni dëgjuar ndonjëherë ndonjë gjë të ngjashme gjatë  
23 kohës që keni qenë i ndaluar?

24 PË. Jo, asnjëherë nuk kam dëgjuar diçka të tillë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar.

1 PË. Faleminderit edhe juve.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
3 Barthe ka një pyetje.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Gjykatësi  
5 Smith.

6 Mirëdita, dëshmitar. Edhe unë kam disa pyetje për ju.

7 PË. Mirëdita.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetje: Pak minuta më  
9 përpara, në përgjigje të pyetjes që ju bë nga kolegu im, nga  
10 gjykatësi Gaynor, ju thatë që kemi folur me vëllain e Osman  
11 Sinanit mbas luftës.

12 A ju kujtohet kjo?

13 PË. Po, më kujtohet.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Së pari, a mund të na thoni  
15 se si quhej vëllai i Osman Sinanit? Si e kishte emrin?

16 PË. Nuk mund ta them, nuk e di.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk e mban mend apo?

18 PË. Nuk e mbaj mend.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju kujtohet se kur dhe ku  
20 e keni takuar vëllain e Osman Sinanit pas luftës? Për  
21 shembull, në cilin vit e keni takuar, në cilin fshat, apo në  
22 cilin qytet e keni takuar?

23 PË. Jemi takuar në Kurshumlij, në qytezën e Kurshumlisë. Kjo  
24 ka ndodhur pas luftës, ndoshta gjashtë apo shtatë vjet pas  
25 luftës.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A u kujtohet se çfarë ju  
2 tregoi ai lidhur me vrasjen e vëllait të tij, e Osman Sinanit?  
3 PË. Ai e dinte që unë isha ndaluar së bashku me vëllain e  
4 tij. Ai tha se vëllain e tij e kishin rrahur deri në vdekje,  
5 me shkopinj. Dhe të, të nderuar Gjykatës, ka gjëra në  
6 Prishtinë, ka gjëra që përkthyesi ka refuzuar që t'i përkthejë  
7 plotësisht. Dhe për këtë arsye, them këtë gjë që vëllai më ka  
8 thënë që e mori trupin e vëllait pas luftës dhe vëllai i tij  
9 është rrahur në vdekje me shkopinj dhe nuk është qëlluar me  
10 armë. Sepse çdo dëshmitar që ka dëshmuar një herë asnjëherë  
11 nuk dëshmonte për së dyti sepse ata kërcënoheshin dhe nuk  
12 guxonin që të shkonin dhe të jepnin përsëri dëshmi. Edhe mua  
13 vetë më kanë kërcënuar gjatë atyre viteve, dhe më shoqëronin  
14 në mënyrë që të mund të jepja dëshminë time në gjykatë. Nuk  
15 kishte një shqiptar të vetëm që guxonte të shkonte të jepte  
16 dëshmi atje. Dhe cilado që të ishte deklarata e parë, ajo  
17 ishte sepse ata nuk shkonin për së dyti për të dhënë dëshmi.  
18 Dhe më pas, dëshmia e dytë apo e tretë thuhej që nuk kishte më  
19 dëshmitarë, nuk ekzistonin më, nuk kishte procesverbal të  
20 tjerë, nuk kishte të dhëna të tjera për ta. Këtë e thoshte ky  
21 gjykatësi italian.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po përsëris pyetjen, pyetja  
23 e fundit për ju Dëshmitar. Familja, a u përpoq të mësonte  
24 ndonjë gjë se çfarë i ndodhi gjatë kohës së ishit të ndaluar  
25 në gusht dhe në shtator të vitit 1998?

1 PË. Familja ime shkonte çdo ditë në Prishtinë, dhe asnjëherë  
2 s'e mësuan çfarë më ndodhi. Sepse në gazetën Bukja thuhej që  
3 është vrarë dhe është hedhur në një kanal. Megjithatë, kishte  
4 thashetheme që isha gjallë. Një thoshte që kisha vdekur, e  
5 kështu me radhë, deri më datën 26 shtator, kur u shfaq. Dhe  
6 familja më kërkonte çdo ditë.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Te cili institucion shkuan?  
8 A e dini, cilit institucion iu drejtua familja juaj?

9 PË. Nuk e di ku shkuan, ku shkonin në Prishtinë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam më  
11 pyetje.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
13 pas pyetjeve të Trupit Gjykses, a ka pyetjet të tjera shtesë  
14 nga palët?

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

17 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe:

18 Z. KEHOE: [Përkthim]

19 PY. Kur ju përgjigjët gjykatësit Barthe, ju thatë "asnjë  
20 shqiptar nuk guxonte të shfaqej atje si dëshmitar në gjykim".  
21 Ju e dini që komunikata s'është e vërtetë, apo jo?

22 PË. Këtë e di se kanë dhënë vetëm një herë dëshmi ata  
23 dëshmitarë dhe nuk u shfaqën më asnjëherë para një gjykate.  
24 Ata që kanë qenë të ndaluar. Besoj se e keni këtë në dëshmitë  
25 që keni përpara, cilët dëshmitarë kanë dhënë dëshmi e kur, që

1 nuk u shfaqën më asnjëherë sepse u kanosën që do t'i vrisnin.

2 PY. Shqiptarët janë paraqitur e kanë dhënë dëshmi kundër

3 Latif Gashit dhe të tjerët të cilët u dënuan - Latif Gashi dhe

4 të tjerët dhe u burgosën për këtë, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Kur ju përgjigje Gjykatësit Barthe për vëllain e z.

7 Sinani, në atë përgjigje ju i thatë Gjykatësit Barthe që nuk

8 ju kujtohej emri kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Por ama kur biseduat me Prokurorinë para disa ditësh, dhe

11 konkretisht kjo është në provën materiale P195, paragrafi 18,

12 Prokuroria ju pyeti për relatat që kishit me vëllain e

13 Sinanit. Dhe ju thatë, dhe po citoj: "Ju konfirmoni se keni

14 marrëdhënie të ngushtë me vëllain e Sinanit edhe sot e kësaj

15 dite". Edhe sot e kësaj dite, që është 16 qershor, 2023 data,

16 të cilës po i referohem.

17 PË. Po, mbaj kontakte me të, flasim në telefon.

18 PY. Po emrin, si e ka.

19 PË. Nuk ja di emrin.

20 PY. Nuk ja di emrin?

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mbase dëshmitari nuk e jep dot

22 emrin sepse jemi në seancë të hapur.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, nuk është nevoja të na

24 mbani fjalime këtu.

25 PY. Keni frikë të na e thoni emrin?

1 PË. Po.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk doni ta  
3 thoni emrin e tij në seancë të hapur?

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk mundem, nuk ja di mirë.

5 Z. KEHOE: [Përkthim]

6 PY. Pra, ky personi nga i cili morët informacionet dhe të  
7 cilat ja thatë Prokurorisë para ca ditësh, dhe me të cilin  
8 keni edhe marrëdhënie të ngushtë, pra një person me të cilën  
9 keni marrëdhënie të ngushtë e bisedon në telefon, ju nuk e  
10 ditkeni emrin? Kështu?

11 PË. Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet. E di vetëm që është nga  
12 Murgolla, jeton në Berane. Kaq di, asgjë më shumë.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Strong?

15 Z. STRONG: [Përkthim] Nuk kemi pyetjet të tjera.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts?

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi pyetjet të tjera.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, i kemi nja dy pyetje.

20 PY. Kur ju përgjigjët gjykatësit Mettrax, ishte një dokument  
21 që ua shfaqën në ekran dhe ishte dokumenti me numër SPOE000 --  
22 do ta vendosim në ekran.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Do ta vendosim në ekran për një çast  
24 dokumentin. Është në serbisht origjinali, por më duket se  
25 kishte edhe përkthimin në anglisht SPOE006813.

1 PY. Më duket se është një deklaratë e marsit të vitit 2011. A  
2 ju kujtohet të keni dhënë këtë deklaratë, Dëshmitar?

3 PË. Kam dhënë një deklaratë po këtu është në shqip. kam thënë  
4 që Latif Gashi më tha që do vriste Mica Joviç, Micko Brecanin  
5 dhe -- kur më lirua, Mice Joviç ishte vrarë, kishte një dhjetë  
6 ditë -- nja dhjetë ditë pas lirimit tim u vra. Fliste --  
7 punonte për shërbimin e brendshëm sekret. Edhe Haki Hoti nga  
8 Bradashi u vra. Edhe ai punonte për shërbimin e brendshëm në  
9 Prishtinë. Edhe ai u vra gjatë kohës që isha i ndaluar. Më  
10 tha, më tregoi edhe për atë, dhe që u vranë. Tani kush i vrau  
11 unë nuk e din.

12 PY. Unë dua t'ju pyes për këtë pjesën e fundit që thatë. Dua  
13 të shtoj një gjë lidhur me EULEX-informacion. "Për turp, në  
14 dhanë vetëm 5000 euro kompensim". Ju kujtohet që keni thënë  
15 këtë në mars të vitit 2011, Dëshmitar?

16 PË. S'e kuptova pyetjen tuaj.

17 PY. Po ju lexoja paragrafin e fundit.

18 PË. Po e kam shqip këtu përpara.

19 PY. Mirë, po ta lexoj unë paragrafin e fundit.

20 Pyetja -- ju bënë një pyetje juve:

21 "A dëshironi të shtoni ndonjë gjë në lidhje me çështjen  
22 tuaj?"

23 Dhe ju jeni përgjigjur:

24 "Dëshiroj të shtoj se këtë gjë që ka bërë EULEX-i është  
25 një turp. Kam marrë vetëm 5000 euro kompensim."



1 A ju kujtohet ta keni thënë këtë në mars të vitit 2011?

2 PË. Jo. As nuk kam marrë ndonjëherë këtë shumë parash.

3 Asnjëherë s'e kam marrë. S'i kam ndonjëherë këto para. Është e  
4 vërtetë që EULEX-i asnjëherë nuk donte të ma tregonte as  
5 aktgjykimin. As paratë nuk m'i dhanë. Duhet të ketë ndonjë  
6 dokument, duhet të ketë ndonjë dokument ku thuhet që i paskam  
7 marrë fizikisht unë këto 5000 euro.

8 Këtu është -- tani unë përpara i kam të gjitha në shqip,  
9 s'i kam në serbisht.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Në duket se e kemi edhe serbishten.  
11 Po shoh nga kolegët.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] I ka në kopje fizike përpara  
13 dëshmitari, dhe më duket se është ndarja numër 9.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis, a  
15 ka lidhje kjo me pyetjet e Gjykatësit, se këto pyetjet vijuese  
16 duhet të kenë lidhje me pyetjet e Gjykatësit.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Është një dokument që përdori  
18 Gjykatësi Mettraux dhe bëri pyetje pastaj për z. Sinani.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po nuk po bëni pyetje për  
20 dokumentin.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju ja keni  
22 bërë një herë më përpara këtë pyetje.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Atij i bënë pyetje bazuar në këtë  
24 dokument dhe unë dua t'i tregoj një aspekt tjetër të këtij  
25 dokumenti, që duket se ka lidhje me një deklaratë që ka dhënë

1 ky dëshmitar.

2 PY. E gjetët serbishten?

3 PË. Po e gjeta, këtu e kam.

4 PY. A është nënshkrimi juaj në fund?

5 PË. Po. Por dokumenti, pra kur e kam nënshkruar unë këtë

6 dokument, në këtë rast e kisha marrë aktgjykimin. E vetmja gjë

7 që kam marrë ka qenë aktgjykimi i fundit vitit 2009. Ma dhanë

8 në vitin 2019.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Kaq kisha.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

11 I nderuar Dëshmitar, përfunduar pyetjet nga palët. Ju

12 falënderojmë për kohën dhe për dëshminë tuaj.

13 Sekretarja do të të shoqërojë jashtë sallës së gjyqit. Ju

14 faleminderit.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit, të

16 nderuar Gjykatës, faleminderit për gjithçka.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për

19 dëshmitarin tjetër, keni të njëjtën përbërje apo keni persona

20 të tjerë?

21 Mirë, do bëjmë pesë minuta pushim, sa të organizohemi,

22 edhe na informoni kur të jenë të gjithë gati.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po a mund të ngre edhe një

24 çështje para se të kalojmë te dëshmitari tjetër dhe ju kërkoj

25 falje për këtë?

1 Diskutuar gjatë seancës pararendëse kartelën mjekësore,  
2 dokumentacionin mjekësor dhe me kanë informuar që  
3 dokumentacioni i ri në anglisht dhe origjinali janë shtuar  
4 tashmë në listën e materialeve dhe kanë marrë shënimin për  
5 identifikim.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jo, nuk kanë numër të  
7 provës materiale, por për sot do të marrin numrin e provës  
8 materiale P196.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbase nesër  
10 do të marrim një vendim në lidhje me këto materiale.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, edhe unë doja të  
12 kërkoja të paraqitej si provë materiale me numër 0023926, që  
13 ishte dokumenti që përdorëm në kur bëmë pyetjet me  
14 dëshmitarin. Sipas meje ky është një material që nevojitet për  
15 të kuptuar kundër pyetjet.

16 Jo, në kundërpjetet më përpara, jo tani.

17 --- Pauza fillon në orën 15.15

18 --- Seanca rifillon në orën 15.22

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
20 fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë 03811.

21 Përpara se të fillojmë Sekretare të kalojmë për një çast  
22 në seancë private të diskutojmë një aspekt.

23 [Seancë private]

24 [Seancë private teksti i fshirë]

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7 [Seancë e hapur]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta  
9 sillni dëshmitarin.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Po, dëshmitari është  
11 këtu.

12 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit përmes  
13 videolidhjes]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita  
15 dëshmitar. Mirëdita Dëshmitar, më dëgjon?

16 Na e thuaj edhe njëherë, na dëgjon?

17 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Para se të  
19 fillojmë me dëshminë do ju kërkoj të lexoni një tekst. Është  
20 një deklaratë solemne që duhet ta lexoni ju në përputhje me  
21 Rregulloren e kësaj Gjykate. Lexojeni me zë të lartë.

22 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] I ndërgjegjshëm për  
23 rëndësinë e dëshmisë time dhe përgjegjësisë time ligjore  
24 deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të  
25 vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë

1 asgjë për të cilën kam dijeni.

2 A e kuptuat?

3 DËSHMITARI: W03811

4 [Përmes videolidhjes]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit

6 Dëshmitar. E dëgjuam. Faleminderit. Uluni.

7 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] E mirë.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Të  
9 nderuar Gjykatës, nëse mund t'ju konfirmoj që të pranishëm  
10 këtu kemi Dëshmitarin W03811. Jemi në vendndodhjen e caktuar,  
11 shoqëruar -- që jam shefi i njësisë për menaxhimin e Gjykatës  
12 dhe një Sekretar Gjykate.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
14 dëshmia juaj mendohet të zgjasë një ditë e gjysmë. Në fillim  
15 do ju bëjë pyetje Prokuroria. Pastaj Mbrojtësi i Viktimave dhe  
16 pastaj do ju bëjnë pyetje ekipet e Mbrojtjes dhe mbase do ju  
17 bëjnë pyetje edhe anëtarët e Trupit Gjykues.

18 Prokuroria mendon se i nevojiten dy orë për pyetjet.

19 Mbrojtësi i Viktimave një çerek ore. Ndërsa ekipet e Mbrojtjes  
20 kanë thënë se ju nevojiten gjashtë orë. U lutemi palëve të  
21 jenë të kujdesshëm me kohën. Trupi Gjykues mund të lejojë edhe  
22 pyetje shtesë nëse përmbushin kushtet për këtë.

23 Dëshmitar, përpiquni të jepni përgjigje të qarta, me

24 fjali të shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen, lirisht

25 kërkoni që pyetja të përsëritet ose thoni "Nuk e kuptova" e do

1 tua sqarojmë.

2 Na thoni nga e dini informacionin që do të na thoni. Ku i  
3 keni mësuar faktet dhe rrethanat.

4 Në qoftë se Prokuroria ju thotë të tregoni korrigjimet që  
5 i keni bërë deklaratës, ju duhet të thoni për procesverbal që  
6 deklarata me shkrim është e korrigjuar dhe reflekton saktë  
7 korrigjimet tuaja. Flisni afër mikrofonit, prisni pesë sekonda  
8 përpara se të përgjigjeni dhe flisni ngadalë që të ndjekin  
9 edhe përkthyesit.

10 Këto dy ditë kur të jepni dëshmi në sallën e gjyqit, nuk  
11 duhet të diskutoni me asnjë përmbajtjen e dëshmisë tuaj jashtë  
12 mureve të sallës së gjyqit. Në qoftë se ju pyet njeri për  
13 dëshminë, na e tregoni këtë. Në qoftë se unë bëj një shenjë  
14 mos flisni më.

15 Në qoftë se e shihni që unë ngre dorën, mos flisni më  
16 sepse unë do të kem nevojë të jap një udhëzim në ato momente.

17 Nëse keni nevojë për pushim na thoni dhe do t'ua  
18 plotësojmë atë nevojë.

19 Do të fillojmë me pyetjet e Prokurorisë.

20 Z. Pace, a jeni gati me pyetjet?

21 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës.

22 Pyetje nga z. Pace

23 Z. PACE: [Përkthim]

24 PY. Mirëdita Dëshmitar. Jemi takuar edhe më përpara unë do të  
25 prezantohem. Unë quhem James Pace. Jam Prokuror i Prokurorisë

1 dhe do ju bëj disa pyetje sot edhe nesër.

2 Përpara se të kalojmë në seancë private që të marrim  
3 informacion për identitetin tuaj, unë ju shpjegova edhe në  
4 seancën përgatitore dje, që nuk do ju bëjmë pyetje për çdo  
5 rrethanë që ju dini. Disa nga deklaratat që keni dhënë më  
6 përpara do t'i pranojmë si prova pa qenë nevoja që t'ju pyesim  
7 përsëri. Por që të bëjmë këtë ka disa procedura, formalitete  
8 që ne duhet t'i ndjekim por këto mund t'i bëjmë pasi të flasim  
9 për identitetin tuaj.

10 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, të kalojmë në  
11 seancë private për të marrë identitetin e Dëshmitarit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E nderuar  
13 Sekretare, kalojmë në seancë private.

14 [Seancë private]

15 [Seancë private teksti i fshirë]

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur]

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni z.

8 Pace.

9 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

10 Do të kërkoj që të shfaqen në ekran dokument që nuk janë  
11 për t'u përcjellë për publikun. Janë dokument ERN 088951-TR-AT  
12 Pjesa 1, RED2. Vetëm faqja e parë. Faleminderit.

13 PY. Dëshmitar, a i shikon në ekran dy dokumenta?

14 PË. Nuk e kuptoj çfarë dokumentash?

15 PY. A sheh përpara dy dokumente në një ekran që ke përpara?

16 PË. Po, po, po i shoh. Po dy dokumenta përpara meje.

17 PY. Dëshmitar, këto dokumenta në të majtë ke shqipen, në të  
18 djathtë anglishten. Këto janë një intervistë që i ke dhënë ti  
19 Prokurorisë në dhjetor 2020. A të kujtohet të jesh takuar me  
20 Prokurorinë në dhjetor 2020 dhe ata ju bënë pyetje çfarë  
21 kishte ndodhur ty dhe të tjerëve në vitin 1998 dhe 1999? Të  
22 kujtohet?

23 PË. Vallah pak më kujtohet që e kam dhënë, po bash kjo -- po  
24 e kam dhënë aty në atë letrën e paraqitur, në atë dokumentin  
25 është. Në dokument e keni.



1 Z. PACE: [Përkthim] Sekretare e Gjykatës ju lutem të

2 nxirrni në ekran dokumentin SITF00032742 deri në

3 SITF0003274632, faqja 32744. Është në shqip po nuk është

4 nevoja të nxjerrim anglishten. As kjo nuk duhet transmetuar

5 publikisht. Asnjë nga materialet që do të përdor me

6 dëshmitarin sot nuk janë për transmetim publik.

7 PY. Dëshmitar, shikon në ekran që doli një dokument tjetër?

8 PË. Po, po.

9 PY. Ky dokumenti në shqip është një intervistë që e ke bërë

10 me UNMIK-un në prill të vitit 2002. Lart fare, djathtas a e

11 sheh emrin tënd, po mos e thuaj emrin. Në krye të faqes në të

12 djathtë, a e sheh emrin tënd? Po mos na e thuaj emrin?

13 PË. Po. Po e shoh.

14 PY. Nënshkrimi jot është ai aty?

15 PË. Nënshkrimi jem është.

16 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, Sekretare e Gjykatës

17 mund t'i hiqni nga ekрани.

18 PY. Dëshmitar, a të kujtohet një koleg, një përkthyes dje të

19 lexoi deklaratat që kishte dhënë më përpara? Të kujtohet?

20 PË. Po.

21 PY. A të kujtohet që pasi të lexoi këto deklaratat

22 përkthyesi, unë dhe një kolegu im të thamë të bëje korrigjime

23 deklaratave që të kishte lexuar përkthyesi. A të kujtohet?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe dje na bëre ca sqarime, bëre ca sqarime lidhur me

1 deklaratat që kishe bërë më përpara.

2 PË. Po dje i kam sqaru ato krejt.

3 PY. Dje, nga fundi i ditës para se të mbaronim unë të lexova  
4 një shënim. Tek shënimi ishin të gjitha sqarimet që na kishe  
5 thënë ti, vetëm për të verifikuar që i kishim kuptuar siç  
6 duhet të gjitha sqarimet. A të kujtohet?

7 PË. Po. Krejt në rregull kanë qenë.

8 PY. Tani, duke pasur parasysh ato korrigjimet që të lexova  
9 dje a mund të themi tani që informacioni në deklaratën tënde  
10 është i saktë me aq sa keni ju dijeni? Gjithmonë duke marrë  
11 parasysh edhe sqarimet që bëtë?

12 PË. Sa kam dijeni unë, veten time i saktë jam q'ato deklaratë  
13 çka i kam dhënë, q'aty para këtyne prokurorëve.

14 PY. Një nga deklaratat që të tregova ishte një deklaratë e  
15 UNMIK-ut. Ishte e vërtetë dhe e saktë përmbajtja kur ja keni  
16 dhënë UNMIK-ut, pra ishte e saktë kjo deklaratë?

17 PË. E saktë, unë kujtoj që e saktë a konë edhe e saktë është.

18 PY. Po ashtu duke marrë parasysh edhe korrigjimet që dhatë  
19 dje, dokumentet që unë përmenda sot, deklaratë e UNMIK-ut edhe  
20 deklaratat që i dhatë Prokurorisë, a përmbajnë të njëjtat  
21 gjëra që do të thonin ju nëse do ju pyesnin prapë sot? Pra a  
22 është përmbajtja ajo që do të thonit edhe sot nëse do ju  
23 pyesnin? Është e saktë? E vërtetë?

24 PY. E vërtetë është. E saktë. Çka të më pyetni kam me ju --  
25 ç'ka të di kam me ju lajmëru. Saktë kam unë me i thanë tjetër

1 fjalë [e pakuptueshme] ça i kam shkru aty.

2 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të kërkoja që  
3 të pranoheshin si prova deklaratat e mëparshme ERN që do të  
4 lexoj tani: 088951-TR-AT, TR-ET, Pjesa 1 deri në 3 dhe pastaj  
5 shqipja përkatëse. Ndërsa deklarata tjetër është SITF00032746  
6 dhe këtu përfshihet edhe anglishtja edhe shqipja. Po ashtu  
7 kërkoj të pranohet materiali me numër 113504, 113611 që është  
8 shënimi i përgatitur ku përfshihen edhe sqarimet që ka dhënë  
9 dëshmitari gjatë seancës përgatitore në përputhje me rregullën  
10 154, deklaratën e rregullës 154.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] ERN 088951-  
12 TR-AT Pjesa 1 deri në Pjesën 3 -- Pjesa 1, 2, 3, domethënë.  
13 Po. E dhjetorit 2020. SITF0032742 deri në 3274632 përfshirë  
14 sqarimet përkatëse 113604 deri në 113611 pranohen si prova dhe  
15 do të marrin numrin e provës materiale.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Materiali 088951-TR-AT  
17 Pjesa 1 deri në Pjesën 3 do të marrin numrin e provës  
18 materiale P197, Pjesa 2 do të jetë P197.1, Pjesa 2 - më falni  
19 - Pjesa 2 do të marrë P197.2, dhe Pjesa 3 P197.3. Më pas  
20 materiali me numër SITF00032742 deri në 0033746 do të marrin  
21 numrin P198. Shënimi përgatitor do të marri numrin 199.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
23 Vazhdoni z. Pace.

24 Z. PACE: [Përkthim] Jemi në seancë të hapur, por do të  
25 doja të kalonim në seancë private për pyetjet e mia duke pasur

1 parasysh masat mbrojtëse të dëshmitarit dhe nevojën për  
2 pyetje.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në  
4 seancë private për të mbrojtur dëshmitarin.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W03811 (Seancë private)  
Pyetje nga z. Pace

Faqe 127

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

1 Dëshmitari ka dalë nga salla.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
3 rifillojmë nesër në orën 9.00.

4 Z. PACE: [Përkthim] Kemi një kërkesë shumë të shkurtër që  
5 nuk lidhet me dëshmitarin. Mund ta bëjnë në seancë të hapur.

6 ZPS-ja kërkon një shtim me 6000 fjalë për një prej  
7 mocioneve që do të dorëzojë në ditët në vijim. Në qoftë se e  
8 miratoni këtë kërkesë tonën atëherë ne do të kishim mundësi të  
9 kërkonim kërkesë për secilin nga dëshmitarët. Kështu që do të  
10 donim që të kërkonim miratimin e kësaj zgjatjeje me 6000 fjalë  
11 të tjera.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Miratohet  
13 kërkesa për shtimin e 6000 fjalëve për përgjigje në kërkesë.

14 Z. Ellis, a mund të na thoni se cili është numri i provës  
15 materiale që ofruat pak më herët.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Është dokumenti U002-3926, besoj.  
17 Megjithatë, më lejoni t'i hedh një sy për ta kontrolluar që  
18 vërtetë ky është numri.

19 Po, ky është numri i saktë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj që këtë  
21 po e parashtroni për çështje besueshmërie, jo për çështje  
22 vërtetësie të faktit, apo jo?

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, për besueshmërinë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, dhe do  
25 t'i caktohet një numër.

1 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duam t'ju  
2 përditësojmë që mund të kemi maksimumi 15 minuta për të pyetur  
3 këtë dëshmitar nesër.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni  
5 Sekretare, vazhdoni dhe na përditësoni.

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
7 Gjykatës, dokumenti U002-3926 deri në 3926 do të marrë, me të  
8 gjithë përkthimet e tjera shoqëruese, do të marrë numrin e  
9 provës materiale 3D2.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
11 Mbrojtja e Veselit do të zgjasë për 15 minuta.

12 Z. Kehoe.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Tre, katër ditë, Gjykatës. Po bëj  
14 shaka. Ndoshta një orë, pak a shumë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully.

16 Z. TULLY: [Përkthim] Edhe ne kemi 10-15 minuta. Po ashtu  
17 sa i takon zgjatjes së kohës, zgjatjes së numrit të fjalëve  
18 mbase është momenti që edhe ne të kërkojmë një shtim të numrit  
19 të fjalëve për parashtrimin tonë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Alagendra.

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Besoj 30 minuta, 40 minuta.

22 Nuk do të na duhet një orë e gjysmë që kemi kërkuar  
23 fillimisht, besoj 30-40 minuta do të jenë të mjaftueshme.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem në qoftë se  
25 mund ta korrigjoj numrin e provës materiale. Do të jetë prova

1 materiale 4D5.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Ka shumë pak të ngjarë që ne t'i  
4 bëjmë ndonjë pyetje këtij dëshmitari.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

6 Pra duket sikur nesër do të përfundojmë me këtë  
7 dëshmitar. Kështu që çfarë plani keni për të mërkurën?

8 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sikur ju  
9 njoftuam të mërkurën që shkoi, dëshmitarët e disponueshëm për  
10 këtë javë ishin dy, 1340 dhe ky dëshmitar. Sikurse e thatë  
11 edhe më përpara ne po përfundojmë më herët sesa kishim  
12 parashikuar dhe gjithashtu dua në vëmendjen tuaj edhe  
13 shkurtimin e konsiderueshëm të kohës që kërkohet nga ekipet e  
14 Mbrojtjes. Në qoftë se dëshironi mund të bëj parashtrime të  
15 tjera me shkrim megjithatë, ju na dhatë disa udhëzime sot  
16 paradite kështu që i kemi marrë shënim ato.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptojmë  
18 këtë gjë. Mos bëni shumë plane për të mërkurën. Megjithatë  
19 mund të ndodhë që mund të diskutojmë, mund të bëjnë një  
20 konferencë për gjendjen gjyqësore, gjendjen e çështjen që ka  
21 të bëjë me publicitetin, kështu që mund të ndodhë që të bëjnë  
22 një mbledhje gjithsesi për të mërkurën.

23 A ka ndonjë gjë tjetër. Në qoftë se jo do ta mbyllim deri  
24 nesër në mëngjes, do të fillojmë serish në orën 09.00 të  
25 mëngjesit nesër paradite.

1 --- Seanca mbyllet në orën 16.03

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25